



Revistë online në shqip e Lëvizjes Europiane në
Shqipëri
ISSN: 2708 - 1656
www.eurospeak.al

Përmbledhje e Artikujve të EuroSpeak

Shkurt– Maj 2021

*EuroSpeak (www.eurospeak.al) revista online e Lëvizjes Europiane në Shqipëri rikthehet e printuar në formatin e një përmbledhjeje të artikujve të botuar në këtë Revistë online gjatë periudhës **shkurt-maj 2021**. Në këtë përmbledhje gjenden një pjesë e mirë e artikujve të shkurtuar dhe të përzgjedhur në sajë të tematikave si: **Menaxhimi i tërmetit në Shqipëri-bilanci pas 1 viti** dhe krahasimi me vendet e tjera me kriza të ngjashme; **Metodologjia e re e Zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe Realiteti Dixhital në 2021**. Një vend të veçantë në këtë përmbledhje përbëjnë artikujt dedikuar **Zgjedhjeve Parlamentare në Shqipëri**, duke evidentuar disa nënçështje si: Mbi amendimet e Reformës Zgjedhore të vitit 2020; Perceptimet e premtimeve elektorale në sektorin e energjisë elektrike dhe qëndrueshmëria tyre në kuadër të proceseve integruese europiane; Ndërkombetarët në retorikën e politikanëve gjatë fushatës; E-voting; Dixhitalizimi i proceseve elektorale si garanci për sigurimin e demokracisë në kohë pandemie; Sfidat e Zgjedhjeve në kohë pandemie.*

Në këtë kuadër kjo përmbledhje përmban artikujt që kanë analizuar çështje madhore, ndodhi dhe ndryshime më të fundit në Bashkimin Europian dhe Shqipëri duke i sjellë ato në një stil publicistik, kombinuar me opinionet e sugjerimet e vetë autorëve, por gjithmonë bazuar në argumente dhe burime të mirëbesuara. Autorët kanë qenë të fushave dhe profileve të ndryshme, duke filluar që nga gazetarë të mirënjohur e me eksperiencë në shtypin e shkruar, analistë dhe politologë, ashtu dhe akademikë, studiues, ekspertë por edhe të rinj e studentë të karakterizuar nga origjinaliteti dhe aftësia e tyre argumentuese. Artikujt e plotë të përfshira në këtë përmbledhje si dhe artikujt e tjerë të botuar i gjeni në faqen online të EuroSpeak, e cila përditësohet në mënyrë periodike me artikuj të rinj dhe elemente të tjerë informativë:www.eurospeak.al.

Speciale: Tërmeti në Shqipëri, 1 vit më pas



Menaxhimi qeveritar i pasojave të tërmetit të 26 nëntorit 2019 në Durrës

Shqipëria është një vend i rrezikuar nga fatkeqësi natyrore si: tërmetet, përmytjet apo përhapja e epidemive. Tërmeti me magnitudë 6.4 të shkallës Rihter, në 26 nëntor 2019, goditi Durrësin, Shijakun, Tiranën, Krujën (Thumanë), Kamzën, Kavajën, Kurbinin dhe Lezhën, duke rezultuar në 51 humbje jete dhe 913 të plagosur si dhe dëme të mëdha materiale. Në këto kushte, qeveria aktuale ka ndërmarrë politikën publike të rindërtimit dhe të strehimit, për rimundësimin e kushteve normale të jetesës për familjet e prekura nga tërmeti. Pas më shumë se një viti, elementët dhe instrumentet e politikës së rindërtimit, po shoqërohen me debate lidhur me efikasitetin dhe efektshmërinë e tyre, trajtimin e ndryshëm të qytetarëve, masën e ndihmave si dhe shpejtësinë e procesit të rindërtimit për strehimin e qytetarëve, të vështirësuar nga përhapja e pandemisë Covid 19 në vend.

Politika e rindërtimit është ndërmarrë nga Ministria e Rindërtimit (rindertimi.gov.al), për drejtimin e gjithë procesit, me në krye Arben Ahmetaj, si dhe me Komisionin Shqiptar të Rindërtimit, KSHR (Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, 2019 & Për përbërjen, organizimin e veprimtarive dhe rregullat e funksionimit të KSHR, 2019), si organ kolegjal. Aktorët e tjerë për rindërtimin dhe rivitalizimin e zonave të prekura nga tërmeti janë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Bashkitë, si dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit si njësi zbatuese për rindërtimin e shtëpive individuale; grupimin e rindërtimit të shtëpive individuale në zonat rurale, bashkë me ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse; si dhe ndërtimin e lagjeve të reja urbane. Për këtë, qeverisja ka ndërmarrë rol kryesor për përballimin e pasojave post-fatkeqësi, përkundër një qasjeje nga poshtë-lart e cila sheh si thelbësor rolin e aktorëve në komunitet.

Fillimisht u inspektuan dhe u vlerësuan dëmet strukturore nga ekspertët shqiptarë, me mbështetjen edhe të ekspertëve të huaj, që përcaktuan dhe kategorizuan 5080 ndërtesa (apartamente, shtëpi private, shkolla, hotele, etj) si DS4 e DS5, që u konsideruan të pabanueshme. Në Vlerësimin e Nevojave Post Fatkeqësi, një numër total prej 11,490 njësive të strehimit janë klasifikuar si të shkatërruara tërësisht ose për tu shembur (IFRC, 2020).

Për përballimin e fatkeqësive natyrore është përfshirë në ligjin organik të buxhetit, neni 4/4a (Ligj Organik i Buxhetit, 2016) për buxhetimin në rrethana të jashtëzakonshme: kur ndodhin katastrofa ose fatkeqësi natyrore, aksidente teknologjike apo situata të tjera, të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të qeverisë, që rrezikojnë jetën e shëndetin e shtetasve shqiptarë. Pra qeveria angazhohet për të financuar nga buxheti i shtetit, përveç burimeve të tjera të financimit, për menaxhimin e pasojave të fatkeqësive natyrore si tërmetet. Edhe në ligjin për buxhetin e vitit 2020, neni 7, parashikohet fondi i rindërtimit 20 miliardë lekë, për përballimin e pasojave të tërmetit. Fondi përbëhet nga (Ligji për Buxhetin, 2020): grante, 7 miliardë lekë dhe nga shpenzime të buxhetit të shtetit, 13 miliardë lekë. Në treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar të 2018-2023, në shpenzimet kapitale, përcaktohet fondi për 2021: 28 000 milionë lekë, ose 1.7 % e PBB-së, dhe në 2022 me 6 000 milionë lekë.

Qeverisja në përgjigjen dhe rindërtimin post-fatkeqësi, duhet të përcaktojë agjencitë përkatëse, si dhe fondet në dispozicion, ndihmat nga agjenci apo institucione të tjera si dhe personelin e trajnuar për përballimin e krizave, ose kapitalin human. Sipas autores Laura E. Grube, qeveria duhet të jetë në gjendje që të përcaktojë rregulla loje të qarta dhe të njohura që në fillim; rregullat e mbrojtjes së pronës private; si dhe rregullat që i ndihmojnë aktorët lokalë që të përfshihen në procesin e përballimit të krizës (Grube, 2020).

Mbështetur në Aktin Normativ “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, programi i rindërtimit e nënprogramet përkatëse, përcaktohen në nenin 18 (Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, 2019): zhvillimi i objekteve të reja e i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike, si dhe rikonstruksioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara e të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore; nga autoritetet shtetërore dhe nga donatorët; rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall; programi i bashkëpunimit për ndërtime me sektorin privat. Programi i krijimit të fondit të banesave: i blerjes së banesave të reja në treg dhe i banesave të dhuruara nga privatët. Programi i granteve të rindërtimit: për rindërtimin ose rikonstruksionin e banesave të dëmtuara; pagesa e qirasë për familjet e pastreha nga tërmeti; kompensimi i shpenzimeve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike: kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia; masat për rimëkëmbjen sociale; masat për rimëkëmbjen ekonomike si dhe masat rikuperuese dhe parandaluese.

Rasti i Qarkut Durrës (Bashkia Durrës, 2020): Aktualisht, 15 muaj pas tërmetit, referuar Vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës (Këshilli Bashkiak Durrës, 2020), janë miratuar që nga 29.05.2020 - 24.02.2021, 13661 subjekte përfituese të grantit të rindërtimit, në masat 100 mijë lekë për ndërtesat DS1, 250 mijë lekë për DS2 dhe 500 mijë lekë për DS3. Pra, procesi i rindërtimit përfshin riparimin e banesave nga familjet që kanë përfituar nga granti për rikonstruksion si dhe riparimin e ambienteve të përbashkëta të pallateve nga shteti.

Sipas Kryetares së Bashkisë Durrës, një vit pas tërmetit, 9700 familje përfituan grantin e rikonstruksionit, 4800 familje bonus qiraje, 31 shkolla e kopshte të reja, 30 pallate do rindërtohen në truallin e mëparshëm (2 kanë nisur nga puna), 123 pallate DS4 janë në fazën e hartimit të projekteve të detajuara, 904 banesa individuale, 615 pallate po rikonstruktohen në hapësirat e përbashkëta (shkallë, ashensorë e fasada) si dhe 2 lagje të reja me standarde bashkëkohore do të ndërtohen në Spitalë dhe Manëz (Durrës Lajm, 2020).

Pavarësisht numrit aktual të subjekteve përfituese të grantit, ka patur mjaft diskutime në lidhje me procedurat e institucioneve përgjegjëse, që nga njoftimet dhe deri tek afatet dy-tre ditore për kryerjen e aplikimeve që nuk mjaftuan për qytetarët (pa harruar edhe emigrantët) e grumbulluar nën kërcënimin e pandemisë Covid-19. Madje një numër i madh aplikimesh presin momentin tjetër të rihapjes së sistemit. Vështirësi kishte edhe në sigurimin e ekspertizave të ndërtesave, për plotësimin e dokumentacionit për aplikim.

Më 29 dhjetor 2020, në orën lokale 12:19, një tërmet i fuqishëm me magnitudë 6.2 goditi Kroacinë, në Petrinja, që u pasua nga shumë pas-goditje. Tërmeti shkaktoi 7 humbje jete dhe shumë të plagosur. Bashkimi për Mbrojtjen Civile u vendos në krye të situatës për përballimin e pasojave. Kryeministri i Kroacisë, Andrej Plenkovic ka theksuar ndihmën e madhe nga vende të Europës (si vend anëtar i BE-së) dhe jashtë saj, si dhe përdorimin e fondit prej 683 milion euro nga Fondi Europian i Solidaritetit, për pasojat e tërmetit të marsit 2020 në Zagreb si dhe angazhimin e Presidentit të Komisionit Europian për të ndihmuar edhe për tërmetin e 29 dhjetorit. Ministria e Zhvillimit Rajonal e Fondeve të BE-së do të koordinojë punën për vlerësimin e dëmeve dhe aplikimin për fonde nga Fondi i Solidaritetit (Government of Republic of Croatia, 2020). Po ashtu, qeveria kroate aprovoi 120 milionë kuna (Government of Republic of Croatia, 2020) dhe shteti do të mbulojë të gjitha kostot e rindërtimit në zonat e prekura në Zagreb, edhe zonat e Sisek-Moslavinës e Karlovacit. Shteti do të mbulojë 60% të kostove të rindërtimit, 20% do të mbulohen nga autoritetet rajonale ose nga shteti, si dhe 20% nga pronarët, apo shteti, që do të vendosë një barrë hipotekore mbi pronat. Aktualisht në zonat e Sisek-Moslavinës ka 36617 aplikime për inspektimin e ndërtesave, janë realizuar 20370 dhe 2575 janë përcaktuar të pabanueshme, e 4212 përkohësisht të pabanueshme, ndërsa në Karlovac 804 ndërtesa të pabanueshme (Government of Republic of Croatia, 2020).

Nisur nga mënyra në të cilën po realizohet politika e rindërtimit në Shqipëri, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, edhe në qarkun e Durrësit, mund të dilet në përfundimin se ky proces ka qenë relativisht i ngadaltë, me paqartësi dhe me vonesa të cilat kanë ndikuar në jetesën dhe mirëqënien e qytetarëve. Qeveria shqiptare, ashtu si në Kroaci ka marrë rolin kryesor në rindërtim. Megjithë rolin e qeverisë në sigurimin e fondeve dhe të burimeve të tjera, janë hasur një sërë problematikash të lidhura me efikasitetin dhe efektivitetin e procesit, si: ekspertizat e ndryshme, afatet kohore, paqartësi dhe mungesë informacioni për subjektet, masat e ndihmës, disbursimin e fondeve për bonuset e qerave apo edhe për përfituesit e granteve, problemet në lidhje me ndërtesat e klasifikuara DS4, etj. Rindërtimi dhe rikthimi në normalitet duhet të përfshinte rregulla të qarta dhe

të njohura për qytetarët, më shumë transparencë përsa i përket dëmeve strukturore të konstatuara në ndërtesat e inspektuara, trajtimeve me bonuse qiraje si dhe grantet e rindërtimit, në lidhje me: afatet e aplikimit, kriteret, ekspertizat e thelluara, zonat e reja të zhvillimit dhe të drejtat mbi pronësinë, si dhe lehtësirat apo ndihmat e tjera të parashikuara, nga burime të ndryshme. Për më tepër, ka mjaft paqartësi akoma edhe sot, pas 15 muajsh, në lidhje me rikonstruktimin apo konsiderimin për prishje të detyruar të ndërtesave të klasifikuara DS4, për shkak të diferencave në akt-ekspertizat apo problematika të tjera, duke ndikuar në perceptimet e masave si gjysmake e të pamjaftueshme dhe të lidhura me përfitime elektorale, për zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Në kushtet kur qeverisja ka rolin kryesor në menaxhimin e pasojave post-fatkeqësi dhe rindërtimin, duhet të kishte koordinim më të mirë mes institucioneve, duke mbështetur aktorët lokalë, bizneset dhe qytetarët, që në një kohë më të shkurtër, ti riktheheshin jetës normale, edhe në situatën e vështirë të përhapjes së pandemisë Covid-19.

Marsida Ismaili, mars 2021



ZGJERIMI I BASHKIMIT EUROPIAN DREJT BALLKANIT PERËNDIMOR

Kushtëzimi (conditionality) i BE në Ballkanin Perëndimor: A po dëshmon i suksesshëm në procesin e demokratizimit?

Në fillim të vitit 2020 Bashkimi European (BE) prezantoi metodologjinë e re të zgjerimit, e cila në plan të parë riafirmon angazhimin e BE për integrimin e vendeve të Ballkanit

Perëndimor. Ndërkohë, nga ana tjetër në rajon vihet re një rritje e numrit të nismave paralele rajonale, duke përdorur dhe arsyetimin e integritit rajonal ekonomik si rrugë drejt integritit europian. Nga ana tjetër, bazuar në qasjen racionaliste të studimeve europiane, kushtëzimi është mjeti më i fuqishëm që Unioni përdor për demokratizimin e vendeve. Në këtë kuadër dhe përqaftimi i nismave të ndryshme nga ana e vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6)** zhvillohet sipas logjikës së 'shkopinjve dhe karrotave (sticks and carrots). Megjithatë, gjatë 2020 një seri refuzimesh sidomos për rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut rrezikojnë rritjen e 'eurofatigue' në këto vende si dhe besueshmërinë.

Kushtëzimi si koncept rrjedh nga qasja racionaliste e studiuesve të zgjerimit dhe integritit europian. Sipas këtij grupi studiuesish, Bashkimi European transferon rregullat e tij në vendet candidate përmes shpërblimeve (Moravcsik, A., & Vachudova, M. A., 2003), të cilat do të alokohen në rast të përputhshmërisë me *acquis communautaire****. Sidoqoftë, kërkesat ndryshojnë me kalimin e kohës bazuar në progresin e vendit, si dhe mësimet e nxjerra nga zgjerimet e mëparshme. Së fundmi, problemet e brendshme të Unionit si Covid-19, Brexit, kriza e refugjatëve kanë vendosur procesin e zgjerimit të BE-së në pikëpyetje. Ndikimi (leverage) dhe ndërlidhjet (linkages) e BE-së në Ballkanin Perëndimor janë të larta dhe asimetrike. Leverage si koncept merret me ndikimin që Bashkimi European ka në qeveritë dhe kryesisht merret me aspektin e varërisë së këtyre qeverive ndaj BE-së. Unë përdor konceptet e prezantuara nga Way dhe Levitsky (Way, L.A. and Levitsky, S., 2007) për ndikimin perëndimor, por e ngushtoj atë në marrëdhëniet midis BE-së dhe shteteve individuale të Ballkanit Perëndimor. Linkages i referohet ndërlidhjeve dhe rrjeteve ndërmjet BE-së dhe BP6.

Qasja konstruktiviste përqendrohet më shumë në vlerat dhe mekanizmat kognitiv. Vendet që aspirojnë të aderojnë kanë një përshtatje më të shpejtë me kërkesat e BE-së sepse normat e përqaftuara nga popullsia janë të njëjta me ato që unioni ka. Gjithashtu, kjo qasje merret më shumë me procesin e të mësuarit shoqëror. Ky grup teoricienësh nuk e mohon rolin e kushtëzimit (si faktori kryesor i konsideruar nga racionalistët), por ata pretendojnë se përputhja e normave ndërkombëtare dhe atyre lokale luan rolin më të rëndësishëm në proces. Normat e BE-së dhe normat e elitës lokale gjatë procesit të integritit në BE operojnë duke u bazuar në "logjikën e përshtatshmërisë" (Pollack, M., 2008). Në rastin e Ballkanit Perëndimor, mozaiku i kulturave dhe qëndrimeve ofron një panoramë të ndryshme për secilin prej tyre. Pavarësisht normave dhe qëndrimeve

të ndryshme ndaj BE, të gjitha vendet janë në rrugën e tyre drejt integritit, sigurisht në faza të ndryshme. Por, si kanë ndikuar nismat rajonale në efektshmërinë e kushtëzimit si instrument?


Vendet e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e një sërë nismash paralele. Përpos nismave të ndërmarra nga BE, një sërë nismash rajonale janë ndërmarrë në këto vitet e fundit. Rajoni i Ballkanit Perëndimor është prej vitesh i angazhuar në procesin e integritit në BE, por Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk arritën të marrin një dritë jeshile në hapjen e negociatave. Nga ana tjetër, Procesi i Berlinit është aktualisht iniciativa më aktive e promovuar nga disa shtete anëtare të BE-së, si një alternative e dukshme për t'i mbajtur vendet të përfshira me narrativën pro BE-së, ndërkohë që në të vërtetë janë lënë në pritje lidhur me hapat konkrete për t'u anëtarësuar. Nga ana tjetër, ekzistojnë një sërë nismash të ndërmarra nga shoqëria civile në rajon, për të nxitur frymën e bashkëpunimit rajonal dhe integritin në BE. Kohët e fundit, "mini-Schengen" është nisma më e re ndër-qeveritare, e prezantuar nga 3 liderët e vetëm 3 nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.

Shtypa dhe nismëtarët më të mëdhenj të bashkëpunimit rajonal kanë qenë vendet e Bashkimit Europian. Kjo, si kusht për t'u anëtarësuar në BE, si dhe plotësuese e kushteve kombëtare që secili vend duhet të plotësojë. Pavarësisht kësaj, ekziston një kakofoni nismash paralele, të cilat në fakt rrezikojnë 'kushtëzimin dhe besueshmërinë'. Procesi i Berlinit u pa nga kritikët dhe studiuesit si një nismë që 'fitoi kohë' ndërkohë që BE nuk po zgjerohej dhe që në fakt mbante gjallë shpresën dhe besimin në procesin e zgjerimit. Ndërkohë, në lidhje me nismat e tjera si mini-Schengen në ndryshim nga sektori i OShC-ve (i cili gjithashtu ka të metat e tij) qeveritë duhet të pranojnë se iniciativat paralele dhe jo të ndërlidhura, në Ballkanin Perëndimor, nuk ndihmojnë aspak as bashkëpunimin e tij, as edhe integritin e rajonit në BE. Asnjë nga iniciativat nuk ka një ndjekje dhe vazhdimësi konkrete përsa i përket teknikaliteteve të zbatimit apo planeve të veprimit. Bashkëpunimi rajonal dhe integriti në BE kanë nevojë për një qasje të strukturuar nga të dyja palët, si nga ana e BE-së edhe nga qeveritë e rajonit. Nevoja për reforma të thella, të strukturara është imediate.

Ndërkohë, së fundmi në Mars u prezantua dhe metodologjia e re e zgjerimit, e cila si kryefjalë të sajën pati 'besueshmërinë' dhe ri-vendosjen e perspektivës së integritit, sidomos për rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut****. Një analizë e deklaratave të Këshillit dhe Komisionit nxjerr në pah se në fakt rivendosja e besueshmërisë dhe krijimi i mekanizmave të rinj të kushtëzimit, si grupimi në clusters të kapitujve, apo logjika e hapjes konsekuative, tregon se deri tani mekanizmi i 'kushtëzimit' ka qenë jo-efektiv. Pra, unioni e ka parë të arsyeshme rivendosjen e një perspektive dypalëshe. Megjithatë, pavarësisht kësaj, hapja e negociatave për të dy vendet e cila pritej në dhjetor 2020, është shtyrë për 2021 (EWB, 2020). Në rastin e Maqedonisë së Veriut, kur vendi është përballur me një ndryshim identitar sa i takon emrit, një vendim i tillë rrezikon të rrisë euro-skepticizmin në vend (DW, 2020).

Kushtëzimi funksionon kur përfitimet dhe ndëshkimet janë të qarta si dhe ndikimi dhe lidhjet midis BE dhe BP6 janë funksionale. Në një rajon ku ka një kakofoni nismash, është e nevojshme që metodologjia e re e zgjerimit të zbatohet nga të dy palët. Së fundmi, me refuzimet e shumta nga ana e BE-së duket sikur 'karrotat' po mungojnë dhe një qasje e tillë nxit më tej populizmin në vend. Ndërkohë, nga ana tjetër vendet e BP6 si dhe qeveritë e tyre duhet të qëndrojnë të angazhuar në proces. Është përmes angazhimit real nga të dy palët dhe besueshmërisë në proces, që kushtëzimi funksionon. Të gjitha nismat e ndërmarra si nga qeveritë dhe BE, në emër të integritit, duhet të krijojnë sinergji dhe jo përsëritje, nëse vertetë perspektiva e zgjerimit është reale.

Lutjona Lula, shkurt 2021



Ndërlidhja e politikës së zgjerimit me rimëkëmbjen

Zgjerimi i Bashkimit Europian në kontinent është kthyer në një nga tiparet përcaktuese të procesit të integritit europian në tërësi. Ama, pavarësisht rëndësisë dhe qendërsisë së tij në zhvillimin e projektit europian, zgjerimi nuk ka qenë kurrë i lehtë dhe rrallëherë është

arrirë pa vënë nën kontroll fillimisht hezitimin e strukturave të brendshme.

Në rrafsh ideologjik, rationale i përpjekjeve të zgjerimit qëndron në integrimin dhe konsolidimin politik, socio-ekonomik dhe territorial të Bashkimit European, duke sjellë kështu përpërimin e idesë dhe projektit të Europës. Ndërsa, në një qasje më praktike, politikave të zgjerimit janë dobiprurëse në stabilizimin e rajonit dhe garantimin e sigurisë së Europës. Ndërmjet këtyre dy qasjeve, ky shkrim përqëndrohet në marrëdhënien midis Bashkimit European dhe Ballkanit Perëndimor në kornizën e politikave të integrimin dhe qëllimisht nuk hulumton dimensionin e sigurisë në kontekstin gjeostrategjik. Për rrjedhojë, nuk shtjellohet çështja e ndikimeve të jashtëme në rajon, sidomos gjatë periudhës së reagimit ndaj pandemisë globale Covid-19, dhe interesi i Bashkimit European për t'i zbrapsur ato.

Në perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, rrugëtimi drejt integrimin në Bashkimin European përfaqëson një proces shtetformimi dhe një model zhvillimi e modernizimi. Në kontekst historik dhe në shpjegim të ndjenjës së përkatësisë së Ballkanit Perëndimor në Bashkimin European, mund të përmbledhet se për vendet e Ballkanit që trokasën në derën e saj, Europa politike ka përfaqësuar shpresën për liri, paqe dhe prosperitet nga e cila historia i përjashtoi në mënyrë arbitrare. Për ta, atyre u detyrohen diçka në këmbim, që do të ishte egoiste t'ua refuzonin (Beaune, 2020). Por anëtarësimi në Bashkimin European është një proces i ndërlikuar, i pazakontë dhe rraskapitës, i cili në thelb kërkon ngritjen e institucioneve të nevojshme ligjore dhe politike për të lehtësuar dhe mundësuar anëtarësimin eventual të vendit kandidat (Copenhagen Criteria).

Së fundmi vërehet se politika e zgjerimit, siç është hartuar dhe po zbatohet aktualisht, nuk është më e aftë të nxisë konsolidimin e demokracisë dhe të sjellë zhvillim mbarëshoqëror të Ballkanit Perëndimor. Rajoni duket se po përjeton një regres socio-ekonomik të tejzgjatur, duke sjellë për rrjedhojë dështimin e politikave të qeverisjes dhe mosfunksionimin e politikave transformuese të Bashkimit European. Ndërsa në dinamikën e brendshme të Bashkimit European mungon dakordësia mbi ritmet dhe mënyrën e integrimin të vendeve të rajonit. Ky konfigurim ka pasqyruar nevojën për reformim të politikës së zgjerimit, ndaj të cilës Komisioni European u përgjigj duke publikuar metodologjinë e re të zgjerimit (KE, 2020), mbështetur nga propozimi paraprirës i Francës, e cila efektivisht kishte paralizuar procesin e bisedimeve me vendet anëtare në pritje të reformimit të procesit.

Metodologjia e re jo domosdoshmërisht ka revolucionarizuar procesin e integrimin por ka njohur çështjet e shtetit ligjor si komponentë kyç të parimit të kushtëzimit të Bashkimit European (conditionality). Zgjatimi institucional politik i Unionit, Këshilli i Bashkimit European, kishte zhvilluar tashmë një mosbesim ndaj mekanizmit raportues të Komisionit European, i cili duke theksuar shpeshherë "nevojën për konsensus dhe stabilitet", përcillte idenë se procesi reformues i vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi tepër kritik. Për pasojë, metodologjia e re ka institucionalizuar kushtëzimin politik të Këshillit, përkundrejt qasjes burokratike të "makinerisë së Brukselit".

Përgjithësisht, treguesit dhe mjetet për të matur dhe gjykuar ecurinë e vendeve kandidatë në zbatimin e reformave dhe harmonizimin e acquis janë përmirësuar. Ama, dhënia e më tepër kompetence rrafshit politik të Bashkimit European rrezikon gjenerimin e ngërçeve gjatë procesit të integrimin, siç dëshmoi veto-ja e Bullgarisë ndaj miratimit të kornizës negociuese të procesit të anëtarësimin të Maqedonisë së Veriut për shkaqe historike. Logjikisht, Republika e Çekisë dhe Sllovakisë rikujtuan se marrëdhëniet dypalëshe historike nuk përkasin në fushëveprimin e negociatave të anëtarësimin. Gjithsesi, ky rast përforcon nevojën për të konsideruar me përgjegjshmëri implementimin e votimit me shumicë të cilësuar në çështje që i përkasin politikës së zgjerimit, në mënyrë që të shmangët mbartja e mosmarrëveshjeve dypalëshe në tryezën e diskutimeve të integrimin.

Për shkak të përmasës dhe kompleksitetit të Bashkimit European, shpeshherë proceset vendimmarrëse janë të ngadalta dhe formati i ri i politikës së zgjerimit do duhet ta adresojë këtë duke i garantuar procesit parashikueshmëri dhe qartësi. Por përpara se metodologjia e re të jetëzohet dhe të ishte e mundur të kryeshin vlerësimet e para, Bashkimi European dhe Ballkani Perëndimor u diktuan të investonin vëmendjen e tyre në menaxhimin e pandemisë globale Covid-19.

Rrethanat e pandemisë Covid-19 shërbyen si stress test për marrëdhënien tashmë të tendosur midis Bashkimit European dhe Ballkanit Perëndimor. Vendet anëtare dhe institucionet e Bashkimit European ishin

fillimisht të ngathët në mbështetjen dhe përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në masat e marra për adresimin e pandemisë. Diçka jo veçanërisht e zgjuar duke marrë në konsideratë faktin se në vendet e rajonit po shquheshin tregues të destabilizimit të garancive demokratike. Por në një moment të mëvonshëm kthjellësie, Bashkimi Europian u investua në mbështetjen e Ballkanit Perëndimor duke mobilizuar mbi 3.3 miliardë euro për trajtimin e krizës shëndetësore të Covid-19 dhe rimëkëmbjen socio-ekonomike pas pandemisë (KE, 2020).

Megjithëse ishte e qartë se përqëndrimi do ishte në përpjekjet e rimëkëmbjes dhe se politika e zgjerimit do vendosej në pritje, pa ndërhyrjen e Bashkimit Europian vendet e rajonit do dalin prej kësaj më të cënueshëm dhe më të pagatshëm të angazhohen në procesin e integritimit. Në një periudhë kur rimëkëmbja nga pasojat ekonomike zë tërësisht vëmendjen e qeverive të rajonit, këto të fundit vështirë se janë të prirura për t'u përfshirë në reforma të shtetit ligjor apo proceseve demokratike. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë, Bashkimi Europian publikoi një plan ekonomik dhe investimesh për të mbështetur rimëkëmbjen dhe konvergjencën ekonomike të rajonit me të Bashkimit Europian (KE, 2020). Paçka se kjo sinjalizon vetëdijen e Bashkimit Europian se kushtëzimi politik duhet shoqëruar me plane konkrete për zhvillim ekonomik, për të shmangur periferizimin e rajonit nga "qendra", nevojitet që Ballkani Perëndimor të përfshihet qënësish në diskutimin për ndërtimin e rendit ekonomik post-Covid dhe "Marrëveshjen e Gjellbër", përsa i përket tranzicionit të gjellbër dhe dixhital drejt qëndrueshmërisë.

Në nivel politik, ndaj presidencës së Republikës Federale të Gjermanisë në Këshillin e Bashkimit Europian përgjatë gjashtë muorit të dytë të vitit të kaluar, pritshmëritë për të udhëhequr integrimin e Ballkanit Perëndimor ishin të larta, ndoshta dhe përtej të mundshmes. Që prej nisjes së procesit të Berlinit, Gjermania është investuar rregullisht në shtyrjen përpara të programit të integritimit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Por mungesa e dakordësisë mbi hartimin dhe përcaktimin e kornizës negociuese të bisedimeve të integritimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut shënoi mosarritjen e qëllimeve të presidencës së Gjermanisë, përfaqësuesit e së cilës e konsideruan këtë mosdakordësi si dëm të Bashkimit Europian ndaj vetvetes. Kështuqë, disa hesape të pambyllura iu lanë pasuesve, qeverisë së Portugalisë (Bunguri 2020).

Në fillim të vitit presidenca e Këshillit të Bashkimit Europian i kaloi Portugalisë dhe konsensusi i përgjithshëm është se kjo presidencë nuk do ketë po aq shtysë të angazhohet në programin e zgjerimit sa paraardhësja e saj. Në platformën e Portugalisë, të përqendruar kryesisht në përpjekjet e Unionit për një rimëkëmbje të drejtë, jeshile dhe dixhitale nga pandemia globale Covid-19 (2021Portugal.EU), lehtësisht vërehet mospërfshirja gjëkund e politikës së zgjerimit të Bashkimit Europian në Ballkanin Perëndimor në përparësitë e programit. Pavarësisht se qeveria portugeze është e përkushtuar fuqimisht në dimensionin social të Bashkimit Europian, duket se përpjekjet e rimëkëmbjes dhe strategjia e vaksinimit e kanë shteruar vëmendjen e tyre dhe se përgjatë kësaj periudhe nuk pritet të ketë përparime të qënësishme në politikën e zgjerimit të Bashkimit Europian.

Ama qartazi politika e rimëkëmbjes nga Covid-19 dhe e ardhmja e politikës së zgjerimit janë të ndërlidhura dhe mënyra sesi Bashkimi Europian do i qaset Ballkanit Perëndimor në strategjinë e vaksinimit dhe të mbështetjes ekonomike do përcaktojë dinamikën midis tyre në vazhdim. Bashkimi Europian do i duhet të trajtojë dhe adresojë ndjenjën e braktisjes të rajonit përsa i përket shpërndarjes së vaksinave dhe të gjallërojë sërish interesin e vendeve anëtare në zgjerimin në Ballkanin Perëndimor. Politika e zgjerimit tashmë është zbehur dhe i nevojitet më tepër kredibilitet në rajon, për të cilin anëtarësimi në Bashkimin Europian mbetet domosdoshmëri.

Daniel Prroni, mars 2021

NGA SHQIPËRIA: Zgjedhjet parlamentare



Mbi amendimet e Reformës Zgjedhore të vitit 2020

Reforma Zgjedhore e vitit 2020, ishte një proces politik dhe legjislativ kompleks, i ndarë në disa momente në largësi nga njëra-tjera. Ky proces në rezultante solli ndërhyrje në tekstin ligjor të “Kushtetutës së Republikës”, “Kodit Zgjedhor” dhe Ligjit “Për partitë politike”. Këto ndryshime ishin ndërhyrje në thellësi të ndryshme, por prekën praktikisht tërë spektrin tematik të çështjeve zgjedhore.

Kjo reformë arriti të tjetërsonte administrimin e procesit zgjedhor, rregullimin dhe kontrollin financiar të veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore, rregullimin dhe kontrollin e përdorimit të burimeve shtetërore përgjatë periudhës zgjedhore dhe vetë sistemin zgjedhor. Çështjet që nuk u prekën thelbësisht ose nuk u adresuan nga kjo reformë ishin sistemi i drejtësisë zgjedhore, ngritja e trupës së administrimit zgjedhor jo politike, dhe transparenca në procesin zgjedhor.

Ndryshimet ligjore të çështjeve zgjedhore erdhën si një konkluzion i disa dinamikave institucionale dhe politike, të brendshme dhe të jashtme. Përmbledhtazi ishin tre linja që shtynë përpara dhe sollën reformën zgjedhore që konkludoi në vitin 2020: debati politik mbi garantimin e integritetit zgjedhor, procesi i integritetit europian të vendit dhe detyrimet që ka vendi në raport me OSBE-në.

Reforma e vitit 2020 ka pikënisjen që në kuadrin e marrëveshjes së dy lidheshive politike më 17 Maj 2017, në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të atij viti. Kuvendi i sapo konstituuar nga ato zgjedhje miratoi menjëherë komisionin ad hoc për të ndërmarrë reformën zgjedhore të zotuar. Megjithatë ky komision, përgjatë një funksionimi formal prej 31 muajve dhe 18 seancave të zhvilluara, nuk veproi si mediumi institucional për hartimin e amendimeve ligjore.

Efektivisht, procesi i Reformës Zgjedhore u dakordësua thelbësisht përgjatë dy momenteve, që ishin e ashtuquajtura Marrëveshje e 11 Janarit dhe 5 Qershorit 2020. Në marrëveshjen e parë, përmbledhtazi u ra dakord për diskutimin e ndryshimeve ligjore në një modul ekstra institucional, Këshilli Politik. Ndërsa në marrëveshjen e dytë u vendos përmbajtësisht kuadri i ndryshimeve ligjore që do të kryheshin. Përpos të gjithë ecurisë institucionale, aktorët politikë në këto dy momente përcaktuan se cili do të ishte konkluzioni i reformës që u krye.

Përpos përpjekjeve të shumta dhe presionit të jashtëm për të garantuar një proces legjislativ me dakordësi të plotë politike, reforma nuk u arrit të ishte e tillë. Vetëm paketa e parë e ndërhyrjes në Kodin Zgjedhor gëzoi mbështetje të plotë politike. Ndërsa amendimi i dytë i Kodit Zgjedhor, amendimi i Kushtetutës së Republikës dhe i Ligjit “Për partitë politike” nuk arritën një dakordësi të tillë.

Për shkak të kësaj dakordësie jo të vazhdueshme përgjatë ecurisë së reformës, konsideratat e prezencës ndërkombëtare dhe partnerëve strategjike pësuan luhajtje. Marrëveshja e 5 Qershorit 2020, së bashku me paketën e parë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, patën vlerësime tërësore nga partnerët strategjikë. Në anën tjetër, vijimi i procesit të reformës në amendimin e dytë të “Kodit Zgjedhor” dhe “Kushtetutës së Republikës”, pa dakordësi, mori kritika të forta.

Megjithatë në kuadrin e gjerë, në interpretim të Raportit të Progresit 2020, shihet një komplimentim nga Komisioni Europian për ecurinë e reformës së kryer. Në tërësinë e konsideratave të Komisionit, e vetmja rezervë e shprehur qendronte në faktin se ndonëse kuadri ligjor kishte pësuar përmirësim të vazhdueshëm, ishte e nevojshme të punohej në drejtim të efektivitetit dhe zbatueshmërisë së tij.

Të dy paketat e ndërhyrjes në Kodin Zgjedhor formalisht passollën amendimin apo shfuqizimin e 72 dispozitave të tekstit ligjor, nga 186 në total. Në aspektin e volumit të tekstit ligjor, krahasimisht kjo ndërhyrje ishte më e vogël se ndërhyrja madhore e ndërmarrë në vitin 2012. Përpos këtij raporti, në aspektin formal, edhe ndërhyrja e vitit 2020 solli një tjetërsim po aq thelbësor.

Çështja që mori vëmendje prioritare në këto ndërhyrje ishte mekanizimi i kontrollit dhe transparencës së veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore. Këto ndryshime prekën tërë spektrin e tematikës, si tagrat e institucionit kontrollor, kufizimet dhe ndalimet të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjekteve zgjedhore, si dhe penalitetet për shkeljet administrative respektive.

Megjithatë, vlerësohet se këto ndryshime nuk adresuan tre tema thelbësore përsa i përket mekanizmit të kontrollit të veprimtarisë financiare. Në mosadresim të këtyre temave, mekanizmi i kontrollit dhe transparencës së veprimtarisë financiare vazhdon të mbartë një pamundësi funksionimi real. Ndër këto, madje më kritikë, është fakti që mekanizmi vazhdon të jetë i mbështetur në një proces raportimi vetëdeklarues të veprimtarisë financiare nga subjektet zgjedhore. Kontrolli auditues do të vazhdojë të kryhet përsa deklarohen vetë partitë, pa ndjekur në mënyrë sistematike veprimtarinë financiare reale. Kësisoj, vendosja e vullnetit deklarues të subjekteve zgjedhore në themel të kontrollit e bën në parim rregullimin fiktiv.

Gjithashtu amendimet nuk sollën ndryshime në raport me sigurimin e një transparence më të lartë të veprimtarisë financiare politike dhe nuk vendosën ndalesë për fushatën zgjedhore nga të tretë ("hije"). Kjo e dyta, vazhdon të lejojë cilindo të përkrahë subjekte zgjedhore në mënyrë të pavarur dhe pa detyrimin për të deklaruar asnjë të dhënë financiare.

Përsa i përket administrimit zgjedhor, amendimi më madhor qendronte në largimin e trupës në detyrë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rikonstituimi i kësaj trupe në mënyrë tripalëshe. Kjo ndërmarrje u argumentua si një përpjekje për depolitizimin e trupës së anëtarëve dhe në funksion të një organizimi më të mirë të institucionit. Megjithatë ky ridimensionim nuk ndryshoi mënyrën e përzgjedhjes së kësaj anëtarësie nga Kuvendi i Shqipërisë. Përzgjedhja e kësaj trupe në thelb vazhdoi të ishte e rregulluar sipas një mekanizmi preferencial mazhorancë-opozitë parlamentare.

Funksionimi i KQZ-së u rregullua ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Përmbledhtazi këto tre struktura ndajnë tre funksionet madhore të trupës së mëparshme në raport me procesin zgjedhor. Komisioneri Shtetëror ngarkohet me detyrat ekzekutive në administrimin e procesit zgjedhor dhe është titullari i institucionit të KQZ-së. Komisioni Rregullator ngarkohet me detyra legjislative në miratimin e nënakteve që rregullojnë procesin, dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ngarkohet me shqyrtimin administrativ të ankimimeve të depozituara në raport me procesin zgjedhor.

Ridimensionimi i trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerësohet në parim që do të duhet të përmirësojë mbarëvajtjen në administrimin e procesit. Megjithatë, ky organizim tripalësh brenda të njëjtit institucion mbart pikëpyetje organizative dhe mundësi konflikti ndërmjet tre strukturave. Gjithashtu, ky ridimensionim nevojitet të shoqërohet dhe me një rimodelim të organikës së institucionit së bashku me një analizë nevojash në burime përfshirë njerëzore, ekspertize dhe financiare.

Ndërkohë ndërhyrjet në "Kushtetutën e Republikës" dhe paketa e dytë e ndryshimeve në "Kodin Zgjedhor" kishin për objekt sistemin zgjedhor. Para ndërhyrjes, sistemi zgjedhor për Kuvend në Shqipëri ishte një sistem proporcional rajonal me përzgjedhje preferenciale të mbyllur. Lista shumëemërore e subjektit zgjedhor ishte me rend zbritës dhe mandatet e subjektit zgjedhor iu alokoheshin kandidatëve sipas atij rendi. Amendimi solli një risi në mënyrën e votimit të listës shumëemërore të kandidaturave të subjekteve zgjedhore. Referuar këtij ndryshimi, listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore nuk do të jenë më të mbyllura, por gjysëm të hapura. Kësisoj qytetarët pasi votojnë për subjektin zgjedhor, do të mund të shfaqin preferencën e tyre edhe për kandidaturën në listën shumëemërore.

Dy sipërmarrje madhore që sollën ndryshimet e kësaj Reforme në Kodin Zgjedhor ishin votimi i shtetasve shqiptarë jashtë vendit pranë vendbanimeve të tyre, si dhe përfshirja e teknologjisë së informacionit në verifikimin dhe votimin e zgjedhësve. Në të dyja rastet, legjislatori i njohu si perspektiva në amendimin e Kodit Zgjedhor, por barrën rregulluese apo normative ia ngarkoi institucionit të KQZ-së. Sfidë kjo akoma më e pamundur në rrethanat e emergjencës shëndetësore, si dhe një periudhe shumë të shkurtër përgatitore para Ditës së Zgjedhjeve.

Procesi i Reformës Zgjedhore të vitit 2020 në tërësinë e tij mund të konsiderohet pozitiv apo së paku nuk hodhi hapa pas në garancitë e ofruara nga kuadri ligjor zgjedhor. Megjithatë, edhe kjo reformë e mbajti autorësinë ekskluzive të lidërshipeve politike bipartizanë. Nëse përdorim një metaforë, edhe një herë ishin “lojtarët” që miratuan “rregullat e lojës” dhe përcaktuan “arbitrin”.

Në këtë kuadër procesi i konsultimit publik përgjatë tërë procesit legjislativ, ose mungoi tërësisht, ose në disa raste ishte fiktiv. Kontributi i aktorëve civilë ose institucionalë në opinione dhe rekomandime nuk u bë në asnjë rast objekt i diskutimit nga udhëheqjet politike. Akoma më kritike ishte mungesa e transparencës për diskutimet dhe axhendën e punës, veçanërisht përgjatë punës së Këshillit Politik.

Kësisoj, përta i përket ecurisë formale apo procedurale për reformimin e kuadrit ligjor zgjedhor dy janë sfidat që rëndojnë për të ardhmen. Së pari, harmonizimi i kuadrit ligjor zgjedhor brenda vetes dhe me legjislacionin në tërësi. Gjithashtu nevojitet institucionalizimi i një debati të vazhdueshëm për kuadrin ligjor zgjedhor, përtej punës së një komisioni parlamentar ad hoc.

Kuadri ligjor zgjedhor është formalisht dhe përmbajtësisht i fragmentarizuar në disa akte ligjore. Përmenden “Kodi Zgjedhor”, Ligji “Për partitë politike”, “Kodi Penal”, Ligji “Për mediat audiovizive”, dhe në disa elementë edhe në akte të tjera ligjore. Një zgjedhje e legjislatorit jo e mirëmenduar apo me një vizion të caktuar, por që ka ardhur sipas ecurisë legjislative. Natyrshëm kjo ka sjellë mangësi ligjore në përkufizime fenomenesh, përkufizime kundërthënëse, apo mospërputhje ndërmjet periudhës zgjedhore dhe asaj kalendarike.

Reald Keta, prill 2021

Ndërkombëtarët në ligjërimin e lidërshiptit politik në Shqipëri



Raportet mes gjuhës dhe politikës janë bërë objekt studimi prej kohësh. Për Christinam (Christinam, 1997), një problem në kompleksin e gjuhës dhe politikës është se si të përcaktohet se çfarë është politikë. Veçanërisht në shekullin XX, si rezultat i zgjerimit masiv të shtypit dhe medias elektronike, gjithnjë e më shumë njerëz janë të ekspozuar ndaj ligjërimin që mund të karakterizohet si politikë në natyrë. Mundësitë për çdo person që të jetë pak a shumë i përfshirë në ligjërimin politik, janë rritur jashtëzakonisht.

Për Fairclough I. dhe Fairclough N. (Fairclough I., Fairclough N., 2012) ngjarjet ligjërimore formohen nga situatat, institucionet dhe strukturat sociale, por ajo gjithashtu i formon ata. Në analizën e ligjërimin, gjuha përdoret për të thënë dhe për të bërë diçka, duke qenë e lidhur me kontekstin në të cilin përdoret. Në të njëjtën linjë qëndron dhe Van Dijk (Van Dijk, 1977), i cili mendon se në ligjërimin politik, strategjitë dhe strukturat e argumentimit mund të organizojnë një diskutim politik, në të cilin qëndrimet e kundërta të të tjerëve sulmohen në mënyrë sistematike, ndërsa ata të grupit politik mbrohen ose luajnë me termat, në funksion të ekzagjerimit ose minimizimit të përmasave të një realiteti politik.

Nëse zbresim në kontekstin politik shqiptar, lojërat me termat në funksion të qëllimeve politike predominojnë ligjërimin politik. Termat përgjithësues si Europa dhe SHBA, janë ndër më të përdorurit dhe kjo ka një shpjegim, pasi, në tërësi, vendeve jashtë BE-së, ose në periferinë e saj, Europa dhe SHBA-ja nuk janë vetëm modele demokracie apo strategji legjitimimi i programeve dhe alternativave politike, por mbi të gjitha i ligjërimin politik të përditshëm. Shpesh, heterogjeniteti i qëndrimeve, interesave, konteksteve apo bindjeve të caktuara politike të aktorëve apo institucioneve të ndryshëm ndërkombëtare, zerohen në përmbajtjen e ligjërimin të aktorëve lokalë në Shqipëri kur lind nevoja për të legjitimuar në sytë e opinionit publik një kauzë apo aksion të caktuar politik, ndërsa kur interesi i tyre nuk përkon me komentet e përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare, gjuha dominohet nga terma të personalizuar, etiketues dhe fytes.

Për arsye studimore kemi marrë si rast studimor dy liderët e forcave kryesore politike, Kryeministrin Rama dhe drejtuesin e Partisë Demokratike Basha për të parë natyrën e ligjërimit. Janë përzgjedhur deklaratat e tyre për periudhën janar 2018 – dhjetor 2019 në faqet zyrtare të partive politike që ata drejtojnë. Në faqen zyrtare të Partisë Demokratike janë analizuar 144 fjalime dhe deklarata për shtyp të kryetarit të kësaj partie Lulzim Basha për vitin 2018, dhe 127 për vitin 2019. Ndërsa në faqen zyrtare të Kryeministrit Rama janë analizuar fjalimet dhe deklaratat për shtyp, specifikisht 191 për vitin 2018 dhe 133 për vitin 2019. Metoda e përdorur është metoda e analizës së përmbajtjes e kombinuar me metodën e analizës së ligjërimit.

Referuar termave më të përdorur në ligjërimin e kryetarit të Partisë Demokratike Lulzim Basha për vitin 2018 janë: Europa, Bashkimi Europian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Partitë Popullore Europiane dhe Budenstagu, ndërsa më pak përmenden termat: Shtëpia e Bardhë, Departamenti i Shtetit, Komuniteti Ndërkombëtar, Eurodeputetët, Parlamenti Europian dhe Krerët e Bashkimit Europian. Bie në sy fakti që termat: Europë dhe Bashkim Europian janë ndër më të përdorurit krahasuar me SHBA. Nisur nga kjo e dhënë mund të thuhet se për vitin 2018 Basha ka përdorur për referencë apo mbështetje në ligjërimin e tij më shumë termin: Europë, BE sesa SHBA.

Ndërsa në nivele shtetesh dhe qytetesh, Gjermania, Holanda, Italia, Brukseli dhe Franca përmenden më shpesh, ndërsa shtetet që gjejnë më pak përdorim si referencë apo mbështetje në ligjërim janë: Uashingtoni, Danimarka, Greqia, Zvicra etj. Gjermania, siç do të shikojmë edhe te lideri i Partisë Socialiste, zë vend më shumë si referencë apo mbështetje krahasuar me vendet e tjera, por për arsye të ndryshme nga ajo e Partisë Demokratike. Kjo e fundit i referohet më së shumti si mbështetje e kauzave të saj ose si vend që adreson kritika të forta ndaj qeverisë, ndërsa Partia Socialiste i referohet si mbështetëse e liderit Rama në veçanti dhe qeverisë në tërësi.

Në vitin 2019 vërejmë se termat më të përdorur nga Basha janë: Europa, Bashkimi Europian, Budenstagu gjerman, SHBA dhe Këshilli Europian, ndërsa termat më pak të përdorur janë: Shtëpia e Bardhë, ndërkombëtarët, komuniteti ndërkombëtar, eurodeputetët, Komisioni Europian etj. Siç shikohet përsëri dy temat përgjithësues Europa dhe Bashkimi Europian janë më të përdorurit për vitin 2019. Termi i parë përdoret në kuptimin e familjes politike, kulturore dhe ekonomike ku duhet të aderojë Shqipëria, ndërsa tjetra, si referencë e problemeve dhe kritikave që adresohen ndaj performancës së qeverisë.

Interesant është fakti se Basha i referohet më së shumti Europës dhe Bashkimit Europian krahasuar me SHBA. Kjo prirje nxjerr në pah edhe orientimin e liderit Basha që për problematikat që evidentohen në 2018 dhe 2019 të ketë si referencë më shumë atë çfarë deklarohet apo adresohet si kritikë apo sugjerim nga ana e përfaqësuesve të lartë të BE sesa përfaqësuesve apo institucioneve të SHBA.

Për sa i përket shpeshësisë së përdorimit të termave përgjithësues vërehet dallim mes dy viteve. Një arsye lidhet me intensitetin e ngjarjeve të ndodhura në 2019, të cilat kanë nxitur nevojën për legjitimitetin e komunitetit ndërkombëtar. Në këto kushte është luajtur me strategjinë: sa më përgjithësues termi aq më impresionuese në sytë e publikut mbështetja e komunitetit ndërkombëtar. Po ashtu, sa më i përgjithshëm standardi që kërkohet për vende si ne të bëhen pjesë e familjes europiane, aq më legjitime nevoja për ta përmbushur atë standard.

Në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të shteteve apo qyteteve si mbështetje apo referencë, vërejmë se për vitin 2019 kryetari i opozitës Basha iu është referuar më së shumti shteteve si Gjermania, Britani e Madhe, Holanda, Franca dhe Belgjika, ndërsa më pak të artikuluar janë: Italia, Greqia, Uashingtoni dhe Zvicra.

Nga të dhënat e viteve 2018 dhe 2019 del në pah fakti se në artikullimin në nivel shtetesh dhe qytetesh, Gjermania ka një frekuencë përdorimi qartësisht të dukshme në raport me vendet e tjera. Kjo e dhënë tregon jo vetëm për rolin lider që ka ky vend në BE, por edhe për prezencën e saj krahasuar me vendet e tjera të BE në zhvillimet e fundit politike.

Referuar ligjërimin të kryeministrit Rama, vërejmë se gjatë vitit 2018 termat më shumë të përdorur janë: Bashkimi Europian, Europa, Komisioni Europian, Këshilli Europian dhe SHBA. Ndërsa, termat më pak të

përdorur janë: Shtëpia e Bardhë, ndërkombëtarët, Departamenti i Shtetit, komuniteti ndërkombëtar, eurodeputetët, Parlamenti Europian, Institucionet ndërkombëtare etj.

Këto të dhëna tregojnë se gjatë këtij viti, kryeministri Rama ka pasur si fjalë kyçe Bashkimin Europian dhe Europa. Të parin si referencë për legjitimitetin dhe mbështetjen e performancës së qeverisë, ndërsa Europa si sistem vlerash ku mendohet të projektohet në të ardhmen shoqëria shqiptare.

Në nivel shtetesh dhe qytetesh, për 2018 Gjermania, Franca, Greqia, Holanda dhe Brukseli artikulohe me shpesh në ligjërimin e Ramës, krahasuar me shtetet si: Italia, Britania, Uashingtoni, Danimarka etj. Dhe në këtë rast, bie në sy prirja e liderëve shqiptarë për t'iu referuar më shumë vendeve të Europës sesa SHBA-së. Siç konstatojmë në rastin e liderit Basha, edhe te Rama, Gjermania përdoret si referencë për të vlerësuar punën e qeverisë ose si mbështetje për aksionet e saj në raport me opozitën. Pra, të dy liderët i referohen Gjermanisë (institucioneve të saj), por për qëllime të kundërta.

Viti 2019 ka një dinamikë tjetër politike dhe ndërhyrja e komunitetit ndërkombëtar shikohet në disa momente si faktor zgjidhjeje. Bojkoti i parlamentit, mospjesëmarrja në zgjedhje lokale, vendimi për hapjen e negociatave, protestat e opozitës, ngërçi për ngritjen e institucioneve të reja, janë disa nga ngjarjet politike për të cilat kërkohet opinioni apo ndërhyrja e komunitetit ndërkombëtar. Në lidhje me shpeshësinë e përdorimit të termave përgjithësues në këtë periudhë bie në sy fakti se më shumë të përdorur janë: Bashkimi Europian, Europa, SHBA, Këshilli Europian dhe Komisioni Europian, ndërsa, termat më pak të përdorur janë: Shtëpia e Bardhë, Departamenti i Shtetit, ndërkombëtarët, Komuniteti Ndërkombëtar, eurodeputetët dhe Bundestagu. Nga të dhënat, bie në sy shpeshësia e përdorimit të termave përgjithësues Bashkimi Europian, krahasuar me Partinë Demokratike. Së dyti, ndryshe nga Partia Demokratike, SHBA zë më shumë vend në ligjërimin e Ramës për vitin 2019, krahasuar me liderin Basha.

Ndërsa shtetet që përmenden më shumë si burim legjitimiteti apo kritikë adresuar opozitës për 2019 janë: Gjermania, Franca, Holanda, Danimarka dhe Italia, ndërsa më pak të artikuluar janë: Britania e Madhe, Uashingtoni, Greqia dhe Zvicra. Edhe në rastin e Partisë Socialiste bie në sy prirja për t'iu referuar lidërshiptit të BE, Gjermanisë si burim legjitimiteti dhe mbështetjeje. Francës më shumë i referohet si kritikë për qëndrimin e mbajtur në shtyrjen e vendimit për hapjen e negociatave sesa si mbështetje.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se prirja e liderëve shqiptarë për të përdorur terma përgjithësues dhe shtete të veçanta si nevojë për mbështetje apo si referencë për të justifikuar në publik veprimet apo nismat e tyre është e evidente. Së dyti, vërehet tendenca për t'iu referuar më shumë institucioneve të Bashkimit Europian sesa atyre të SHBA-ve. Pavarësisht se kjo e fundit është faktor me shumë influencë dhe ka rol në zhvillimet politike shqiptare, siç kemi argumentuar, në aspektin e peshës që zë në artikulimin e liderëve shqiptarë, SHBA (institucionet e saj) artikulohe më pak se BE. Së treti, të dy liderët i referohen Gjermanisë (institucioneve të saj, përfaqësuesve të rëndësishëm politikë), duke nxjerrë në pah rolin vendimtar që ka kjo e fundit në politikën e jashtme dhe brenda vendimeve që merren në institucionet e Bashkimit Europian. Së katërti, të dy liderët i referohen Gjermanisë, por për qëllime krejt të kundërta. I pari pretendon se mbështet qeverinë dhe kritikon kundërshtarin, ndërsa i dyti mendon për të kundërtën. Së pesti, lideri Basha i referohet më shumë Europës si sistem vlerash sesa Rama, ndërsa ky i fundit i referohet më së shumti Bashkimit Europian si referencë institucionale nisur nga rekomandimet, vendimet dhe opinionet që adreson ndaj Shqipërisë krahasuar me Bashën.

Roland Lami, prill 2021

Perceptimet e premtimeve elektorale në sektorin e energjisë elektrike dhe qëndrueshmëria tyre në kuadër të proceseve integruese europiane



Sektori i energjisë, i cili tradicionalisht konsiderohet i një rëndësie ekonomike të veçantë për Shqipërinë, prej më se dy dekadash ka hyrë në një proces ristrukturimi të thellë. Sa këtu është intensifikuar në mënyrë të qenësishme në vitet e fundit, duke bërë tashmë të jemi në prag të hyrjes në fazën live të tregut të energjisë elektrike përmes bursës së energjisë ALPEX. Për sa këtu, ky sektor po shikohet me vëmendje të shtuar nga forcat politike kryesore që garuan në zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Në këtë kuadër një ndër problematikat e evidentuara është edhe mangësia e trashëguar lidhur me studimet dhe analizat mbi opsionet e mundshme të zhvillimit të tij. Një boshllëk veçanërisht i domosdoshëm për t'u mbushur për sa shikon qëndrueshmërinë e përparimit të reformave të ndërmarra në kuadër të proceseve integruese europiane. Çka e bën të domosdoshme

diskutimet të një niveli të lartë teknik politikash të bashkëndara me aktorët kryesorë duke u bazuar në kornizën strategjike të Bashkimit Europian.

Mirëpo, pikërisht sa këtu më sipër e bën edhe më të vështirë bashkëndarjen e kësaj reforme. Në këtë kuadër, me interes do të ishte të kuptonin planet strategjike të forcave politike, si i transmetojnë tek palët kryesore të interesit (zgjedhësit, përfaqësuesit e biznesit etj.) dhe cili është perceptimi i këtyre të fundit mbi këto zhvillime. Njëkohësisht çfarë kanë të përbashkët dhe dallimet e këtyre planeve dhe si qëndrojnë ato përballë detyrimeve të marra nga vendi në kuadër të procesit të integritimit.

Mbi sa më sipër, ky artikull bazohet ekskluzivisht në analizën e drejtpërdrejtë të të gjitha publikimeve relative të interesit të periudhës më të fundit. Më tej në lidhje me metodologjinë punimi është zhvilluar së bashku me palët e interesit duke ndarë në kohë reale përgatitjen e tij e mbledhur direkt feedback. Sa këtu ka ardhur duke përdorur rrjetet sociale në mënyrë të lirë (d.m.th. pa çuar asnjë kërkesë të posaçme) dhe duke mbledhur mendimin e tyre të lirë.

Kështu, së pari, kemi hapur sondazhin: "Lidhur me sektorin e energjisë elektrike jeni më të kënaqur me premtimet elektorale të: Partisë Socialiste (PS); Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI); Partisë Demokratike (PD)?

Me sa rezulton në finale të këtij sondazhi përgjigjet janë të shumta (69), pjesa më e madhe arritur brenda një kohe shumë të shkurtër (në 6-7 orët e para). Sa këtu tregon edhe interesin e publikut të gjerë për këtë temë të rëndësishme, e cila jo më kot ka marrë edhe vëmendjen e partive politike në programet e tyre elektorale (të cilat kërkojnë në vazhdimësi të identifikojnë dhe të trajtojnë ato tema që kërkohen nga publiku, madje në mënyrë sa më atraktive për të tërhequr këtë të fundit në krahun e tyre).

Në të, pjesa më e madhe, dhe më saktësisht përmbi 68%, është me e tërhequr nga programi i Partisë Demokratike (PD) lidhur me sektorin e energjisë elektrike. Pjesa tjetër mbi 23% beson më shumë në programin e Partisë Socialiste (PS), si dhe rreth 8.6% përqafon programin e Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI).

Për sa këtu, në vijim është nxjerrë një pyetësor i dytë, në këtë rast individual, i cili identifikon aspektet kryesore të premtimeve elektorale të secilës force politike. Së pari kjo i jep mundësinë që analizës tonë t'i shtojmë eventualisht si feedback ato elemente të cilat mund t'i kenë shpëtuar vëmendjes gjatë procesit kërkimor. Por mbi të gjitha jep mundësinë që secili program të kalojë në filtrin e vlerësimit sa i mundshëm (i realizueshëm) dhe i qëndrueshëm duket ai për sytë e palëve direkt të interesit.

Në këtë kuadër, duke vijuar me aspektet më thelbësore të premtimeve elektorale, (kryesisht të përfaqësuesve kryesorë të dy kampeve të mëdha politike), filluam me identifikimin e premtimeve elektorale. Në këtë kuadër,

nisem me forcën e cila duket se gjen edhe mbështetjen më të gjerë të publikut, ku sipas sondazhit specifik të mësipërm rezultoi të jetë Partia Demokratike (pas tij vijuan me PS dhe LSI).

Mbi sa këtu duke u bazuar në sa bërë publike në takimet e hapura për mediat nga PD, pasi që asnjë force s'ka bërë ende publike ndonjë program të shkruar, nga analiza rezultoi se ndër të tjera sektori i energjisë shihet si një ndër levat për shtimin e investimeve të huaja, rritjen e prodhimit vendas, hapjen e vendeve të reja të punës etj. Kjo parashikohet të arrihet me anë të hapjes së tregut, diversifikimit të burimeve, integrimi me atë të Kosovës, mirë administrim, klimë më miqësore, mbrojtje të konsumatorit etj.

Për më shumë, duke hyrë më në detaje, ndër të tjera nga kjo force synohet: Liberalizim i tregut; Krijimi i tregut të përbashkët të energjisë me Kosovën, duke kombinuar prodhimin nga TEC-et në Kosovë për energji elektrike bazë, ndërsa rezervat hidrike të KESH do të përdoren për energjinë e balancimit apo energjinë në kohën e pikut (Euronews Albania, 2021); Nxitjen e ndërtimit të kapaciteteve të reja të mëdha të energjisë së pastër duke u mbështetur në burimet hidrike.

Mirë administrimin e kompanive publike; Eliminimin e pagesave korruptive që u kërkojnë investitorëve dhe sipërmarrjes; Si dhe krijim të një mjedisi të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe miqësor. Pa harruar një paketë fiskale lehtësuese për biznesin që operon në sektorin e energjisë (a2news, 2021).

Nxitje e prodhimit të energjisë nga burime të gjelbra dhe të pastra me fokus energjinë hidrike dhe atë të erës. Bërjen e Shqipërisë vend lider në energjinë e rinovueshme dhe eksportuese në rajon duke subvencionuar energjinë diellore (shqiptarja.com, 2021). Lidhjen e gazsjellësit TAP me TEC-in e Vlorës, për të gazifikuar zonat industriale. Aplikim i projektit magjistrat Jon-Adriatik, duke siguruar një lidhje me magjistralin e gazit me Kosovën.

Lidhur me konsumatorët familjarë, uljen e faturës së energjisë elektrike për 70% të familjeve shqiptare duke ngritur një sistem faturimi me dy fasha dhe duke ulur çmimin e energjisë për ata që konsumojnë deri në 300 kWh në muaj (ATA, 2021). Liberalizim i tregut të energjisë elektrike, duke u dhënë konsumatorëve mundësinë të zgjedhin vetë se te cili operator do ta blejnë energjinë. "Zhdukjen" e gjeneratorëve për backup (gati gjysma e bizneseve, sipas një raporti të BB, deklarojnë se i përdorin akoma ato) (PD, 2021).

Mbi sa më sipër, në sondazhin tonë, pyetjes "Sa i realizueshëm dhe i qëndrueshëm duket programi i Partisë Demokratike lidhur me sektorin e energjisë elektrike në vlerësimin tuaj?", rezultoi me: 25% me 5 vota, 50% me 2 vota, dhe 100% me 16 vota.

Përgjigjet mbi sa këtu siç duket kanë sjellë edhe një përgjysmim të atyre që ishin vetë përkrahësit fillestarë të programit të Partisë Demokratike (47) lidhur me sektorin e energjisë. Pjesa më madhe sigurisht kanë besim në përmbushjen e tij, por fakti më interesant, nisur nga reduktimi i numrave të atyre që japin një feedback, duket se më shumë se për programin mbështetja lidhet me përkrahjen e forcës politike kundrejt kundërshtarit politik.

Në këtë kuadër, duke vijuar me analizën e aspekteve më thelbësore të premtimeve elektorale, dhe fokusuar në identifikimin e premtimeve të Partisë Socialiste, rezultoi se tipike për këtë force është se prezantimi i programit ka ardhur në vazhdimësi, dhe pas paraqitjes në bllok të atij të Partisë Demokratike pati një heshtje për disa ditë dhe më tej një kundër reagim.

Kjo e fundit karakterizohet nga qasja për të sulmuar, sa pretenduar nga PD, duke i quajtur të përmbushura pretendimet e saj ose në proces realizimi, apo edhe pozicionimi në mbrojtje duke hedhur poshtë pretendimin e PD si jashtë realiteti ose të pamundura (pasi do të sillnin falimentimin e buxhetit).

Në çdo rast, mbi sa këtu duke u bazuar në sa bërë publike në takimet elektorale të hapura edhe për mediat, pasi edhe kjo force s'ka bere ende publike ndonjë program të shkruar specifik, konsiston ndër të tjera në faktin se sektori i energjisë ka ndryshuar tërësisht me atë që ishte më herët (para 2014) edhe se akoma është një sektor që ka shumë nevojë për të punuar në mënyre intensive.

Për më shumë duke hyrë më në detaje, ndër të tjera: Është zhdukur aforfeja si një ndër të këqijat më të mëdha të sistemit; Është krijuar një sistem transparent e i kontrollueshëm për qytetarin (tashmë edhe përmes telefonit); Janë eliminuar radhët stresuese për të paguar energjinë elektrike; Numri i ankesave ka rënë në 0.3% të të gjithë numrit të faturimeve. (Durrës Lajm, 2021)

Në veçanti kemi pasur prezantimin e planit të qeverisjes (për ujin) dhe furnizimin me energjinë elektrike pas zgjedhjeve të 25 prillit. Në këtë kuadër gjatë mandatit të tretë, synohet që humbjet në sektorin e energjisë të zbresin deri në 10%. Të rritet siguria e furnizimit për të gjithë, përmes fuqizimit pikërisht të kapaciteteve të shpërndarjes së energjisë elektrike; Të ndërtohen infrastruktura me nënstacione në të katër anët e vendit; Të vijohet me ndërtimin e një rrjeti të ri 20 kilovolt, të cilat do të garantojnë në kompleks me masat e tjera, një siguri të re energjetike e një cilësi krejt të re të shërbimit; Të fuqizohet aspekti teknologjik smart, dixhital, në monitorim e në operim përmes një sistemi duke telekomanduar në distancë të gjitha kabinat (PS, 2021).

Mbi sa më sipër, në sondazhin tonë, pyetjes “Sa i realizueshëm dhe i qëndrueshëm duket programi i Partisë Socialiste lidhur me sektorin e energjisë elektrike në vlerësimin tuaj?”, rezultoi me: 25% me 6 vota, 50% me 1 votë.

Interesant në këtë rast është fakti se numri i përgjigjeve reduktohet edhe më tej. Pra, trendi i mësipërm lidhur me faktin se më shumë se programet përkrahësit synojnë të mbështesin forcat e tyre politike, konfirmohet edhe më tej. Madje në këtë rast, duke konsideruar se duhet të jenë më të shumtë në numër, mund të thuhet që përkrahësit e forcës së majtë ndihen më pak të detyruar të mbështesin në mënyre të zjarrtë forcën e tyre.

Duke vijuar me analizën e aspekteve më thelbësore të premtimeve elektorale, pas atyre të PS dhe PD, kalojmë edhe tek të Lëvizjes Socialiste për Integrim në kuadër të së cilës rezultojnë vetëm disa deklaratime por tepër të kualifikuara, të tilla si: Mbështetje për energjinë e gjelbër dhe këdo që përdor panelet diellore për përdorim shtëpiak; Lehtësim nga taksat mbi prodhimin e paneleve diellore dhe taksim importit të tyre; Kthim në normalitet të ambientit, tokës, ujit dhe ajrit nga ndotja e nga zhvillimi industrial i papërgjegjshëm; Reformim të standardeve të ruajtjes së energjisë në ndërtim bashke me ato antisizmike (Shqiptarja.com, 2021).

Mbi sa më sipër, në sondazhin tonë pyetjes “Në vlerësimin tuaj sa i realizueshëm dhe i qëndrueshëm duket programi i Lëvizjes Socialiste për Integrim lidhur me sektorin e energjisë elektrike?”, rezultoi me: 25% me 2 vota, 75% me 1 votë.

Në vijim të analizës të mësipërme mbi aspektet më thelbësore të premtimeve elektorale të përfaqësuesve kryesorë të dy kampeve të mëdha politike dhe testimit të tyre lidhur me efektet e tyre elektorale është vijuar me përpunimin e karakteristikave dhe dallimeve kryesore të tyre.

Dallime që për hir të së vërtetës nuk janë të qenësishme, p.sh. PD synon nxitjen e prodhimit të energjisë nga burimet hidrike dhe atë të erës, ndërsa PS ka treguar fokus të veçantë këto vitet e fundit në atë PV. Ndërsa Lëvizjes Socialiste për Integrim në propozimet e saj është shumë interesante duke synuar mbështetjen për energjinë nga panelet diellore për përdorim shtëpiak, si dhe reformim të standardeve të ruajtjes së energjisë në ndërtim.

Po ashtu, PS synon përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit deri tek futja e elementeve teknologjik smart, dixhital, etj. Sa këtu pritet të sjellë që gjatë mandatit eventual të tretë humbjet në sektorin e energjisë të zbresin deri në 10%. Një pikë e fortë e programit të PD konsiston lidhur me konsumatorët familjare, uljen e faturës së energjisë elektrike për 70% të familjeve shqiptare duke ngritur një sistem faturimi me dy fasha dhe duke ulur çmimin e energjisë për ata që konsumojnë deri në 300 kWh në muaj. Duke vijuar me përpunimin e tyre nën dritën kornizës ligjore e rregullatore lidhur me qëndrueshmërinë e tyre kundrejt kërkesave të zhvillime praktike dhe për sa shikon procesin e integritit europian, mund të themi që për sa i përket formave të ndryshme të prodhimit të propozuar nga forcat e ndryshme, nëse ka një pikë mbi të cilët të gjithë ekspertet bien dakord është që diversifikimi i burimeve të energjisë krijon optimizim më të mirë të çdo zhvillimi. Diversifikim që në finale do të çohet përpara nga planet e biznesit dhe roli i autoriteteve është thelbësor për sa i takon ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme (kjo e fundit e synuar nga PS).

Kështu që pika më e debatueshme mbetet plani i PD lidhur me konsumatorët familjarë, uljen e faturës së energjisë elektrike për 70% të familjeve shqiptare duke ngritur një sistem faturimi me dy fasha dhe duke ulur çmimin e energjisë për ata që konsumojnë deri në 300 kWh në muaj.

Mbi sa këtu, për konsumatorin familjar deri në vitin 2014 parashikohej një skemë me dy fasha (e konsideruar si një subvencion i pastër brenda sektorit të energjisë): deri në 300 kWh/muaj 7.7 lekë/kWh (rreth 0,055 EUR/kWh); mbi 300 kWh/muaj 13.5 lekë/kWh (afro 0,096 EUR/kWh). Me ardhjen në pushtet të forcës së majtë për të gjithë familjarët tarifa është vendosur në 9.5 lekë/kWh. Pra, nëse i referohemi vetëm tarifës së energjisë elektrike pas 2014 është ngritur për ata që konsumojnë më pak, por është ulur (duke u parifikuar) për ata që konsumojnë më shumë.

Por, më e rëndësishme është se me sa këtu njëkohësisht mori udhë kalimi në rrugën e re (të kërkuar nga proceset e liberalizimit) të mbështetjes për të gjitha familjet në nevojë sipas politikave publike të mirëqenies sociale. Në këtë kuadër, pikërisht për ata që konsumojnë më pak (disa kategori të caktuara) është vendosur një subvencion direkt. Mirëpo, përveç se kjo është rruga e drejtë, kë duhet të mbështesë ky subvencion dhe mbi të gjitha formën dhe cilësinë e tij është pikërisht diskutimi që duhet të bëhet.

Në këtë kuadër, çdo forcë politike që do të vijë në pushtet pas 25 prillit, në bazë të detyrimeve ligjore të Ligji Nr. 43 Date 30.4.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", siç janë ato për "Klientet në nevojë" do duhet të mbështesë më mirë çdo klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruar në raste përjashtimore (Ligji 43/21015 rregullon të gjithë sektorin sipas aspekteve minimalisht kosto-reflektive).

Në finale së bashku me konkluzionet njëkohësisht lidhur me opsionet të cilat shikohen më të përshtatshme në përmbushjen e targeteve të synuara, është e rëndësishme që të evidentohet që paraqitja nga një forcë politike të një programi në sektorin e energjisë bëri të ndiqet edhe nga të tjerat. Në këtë drejtim shumë mund të bëhet brenda sistemit të energjisë për ta bërë më të drejtë. Vetëm duke ndenjur tek ato makro duke qenë se kostot e rrjetit janë të barabarta me energjinë, nuk mund të paguajë njësoj dikush p.sh. në Kukës me atë në Tiranë (jo çdo rrjet ka të njëjtat kosto, në qytetet më të mëdha kostot janë më të larta). Duhet futur tarifat orare, çmimi energjisë në kohë të ndryshme ka kosto të ndryshme, etj. Përveç që shumë më tepër mund të vijë nga ato që lidhen me masat e eficientës (eficienca energjetike, vet-prodhim, menaxhimin e kërkesës, etj.), transparencës (smart metering, faturë më e qartë, portal me oferta etj.), diversifikimi, transporti, politika horizontale etj.

Lorenc Gordani, prill 202

E-voting: Dixhitalizimi i proceseve elektorale si garanci për sigurimin e demokracisë në kohë pandemie



Demokracia është një nga vlerat themelore të Bashkimit Europian (neni 2 i kreut II të Traktatit të Bashkimit Europian TFEU) dhe demokracia nuk mund të mendohet pa një proces elektorale të besueshëm. Neni 21(3) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 25 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike specifikojnë se qytetarët duhet të kenë mundësinë për të marrë pjesë në zgjedhje periodike nëpërmjet votës universale, të barabartë e të fshehtë, për të garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të tyre. Sa i përket kontekstit europian dhe të drejtës për zgjedhje të lira, neni 3 i Protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) parashikon në mënyrë eksplicite të drejtën për zgjedhje periodike në intervale të arsyeshme, për shprehjen e lirë dhe të fshehtë të votës. Kombet e Bashkuara e quajtën pandeminë Covid-19 si krizën më të madhe ndërkombëtare të disa

gjeneratave, dhe kjo preku edhe jetën dhe të drejtat e njerëzve në Europë. Duke qenë se numri i të infektuarve nisi të rritej me shpejtësi, qeveritë morën disa masa të cilat treguan se si emergjencat mund të kenë impakt në ushtrimin dhe garantimin e të drejtave themelore dhe praktikave demokratike. Election-Watch.EU Rapid

Assessment (1) shqyrtoi impaktin e Covid-19 në zgjedhjet në 27 Shteteve Anëtare të BE, në dy vende me perspektivë aderimi si Shqipëria e Maqedonia e Veriut, si dhe në Mbretërinë e Bashkuar si ish Shtet Anëtar, për të hedhur dritë mbi pyetjet kyçe: Cilat zgjedhje u mbajtën, cilat u shtynë dhe si duhet vlerësuar kjo sipas një perspektive të të drejtave themelore?

Në të drejtën ndërkombëtare, nuk ekziston një rregull formal që ndalon shtetet të mbajnë zgjedhjet apo referendimet në situata emergjencash. Sidoqoftë shumë kushtetuta parashikojnë shtyrjen e tyre gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duke shtyrë edhe mandatin e parlamentit. Ky është rasti i Kroacisë, Italisë, Gjermanisë, Greqisë, Polonisë, Lituaniës, Sllovenisë, Spanjës e Hungarisë. (2) Sipas të dhënave të grumbulluara nga Elecdata (3), 2 zgjedhje parlamentare, 1 presidenciale, 5 referendume dhe 5 zgjedhje lokale në vendet e Këshillit të Europës u shtynë në vitin 2020 për shkak të pandemisë Covid-19. Sipas të dhënave të Institutit Ndërkombëtar për Demokracinë dhe Asistencën Zgjedhore (IDEA) (4), nga 21 shkurti 2020 deri në 28 mars 2021, të paktën 78 vende në botë vendosën të shtynë zgjedhjet kombëtare, lokale apo referendimet për shkak të Covid-19, të paktën 113 vende vendosën ti mbajnë zgjedhjet dhe të paktën 52 shtete i mbajtën zgjedhjet pas një shtyrjeje fillestare. Pavarësisht vendimit të shteteve për mbajtjen ose shtyrjen e zgjedhjeve, situata pandemike diktoi nevojën për angazhim të veçantë për sigurimin e të drejtës së votës për qytetarët. Në Francë, zgjedhjet lokale u shtynë pasi vendi u fut në "fazën 3" të pandemisë dhe në sondazhe votuesve iu kërkua të qëndronin 2 metër larg njëri-tjetrit dhe të merrnin stilolapsët e tyre me vete. Përgjigjë e votuesve ra nga 63% në sondazhet lokale të 2014 në 45 % në mars të vitit 2020 dhe kjo solli një shtyrje të zgjedhjeve dhe mandateve të kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë. Në Gjermani, në zgjedhjet rajonale të 15 marsit të vitit të kaluar, punonjësit elektorale veshën dorashka dhe votuesit u lejuan të merrnin stilolapsë me vete. Bilanci që më i lartë se zgjedhjet e fundit të mbajtura 6 vite më parë, por u vu re një numër më i lartë i votimit me postë. Gjithashtu, situata emergjente solli edhe një ndryshim të kuorumit për vendimmarrjen parlamentare në Gjermani (nga 50% në 25% të anëtarëve të parlamentit) madje në disa vende si Qipro, Letonia e Shqipëria seancat parlamentare u zhvendosën online. Në Itali, në muajin mars 2020, ishte programuar krahas zgjedhjeve lokale edhe një referendum për reduktimin e numrit të anëtarëve të parlamentit. Duke parë seriozitetin e situatës në Itali zgjedhjet lokale dhe referendumi u shtynë në shtator të po atij viti. Në Mbretërinë e Bashkuar ishin programuar zgjedhjet lokale dhe bashkiake për datën 7 maj dhe pavarësisht kritikave mbi dembelizmin me të cilin po menaxhohej ndalimi i përhapjes së koronavirusit, qeveria britanike ishte e para në Europë që eliminoi sondazhet dhe zgjedhjet u shtynë për një vit më vonë pavarësisht opionencës në lidhje me këtë. Në Hungari, Ligji për Mbrojtjen nga Koronavirusi (XII/2020) miratuar në 30 mars 2020 specifikonte se nuk do të mbahen zgjedhje deri në fund të periudhës së emergjencës, zgjedhjet e programuara do të anuloheshin dhe zgjedhjet e parashikuara përgjatë periudhës së emergjencës do të organizoheshin 15 ditë pasi emergjenca të kishte përfunduar.

Edhe pse pati shumë dyshime se pandemia mund të shërbente si justifikim për të ndërfutur kufizime të reja në demokracitë e vendeve dhe të drejtat themelore, si partitë politike edhe elektorati e kuptuan arsyen e shtyrjes së zgjedhjeve, sidomos duke parë rëndësinë e ruajtjes së distancimit social për reduktimin e përhapjes së sëmundjes. Të gjitha qeveritë, përfshirë ato mandatet e të cilave u zgjatën, u fokusuan në menaxhimin e situatës emergjente por për shkak të situatave politike të disa vendeve si dhe rëndësisë së gëzimit të së drejtës të votës nga qytetarët, i riskeduluan zgjedhjet në kohën më të afërt të përshtatshme dhe menduan për alternativa ndaj procesit të votimit tradicional.


Kur vjen puna te zgjedhjet, vendimmarrësit duhet të jenë shumë të kujdesshëm në marrjen e vendimit të mbajtjes apo shtyrjes së tyre duke lundruar me kujdes nëpër parametrat kushtetues e ligjorë, pasi në rast shtyrjeje, shtyrja e mandateve për rrjedhojë do të ishte antidemokratike. Nga ana tjetër, vendimi për ti mbajtur zgjedhjet në rrethana të rrezikut nga Covid-19 do të limitonte fushatat dhe do të reduktonte pjesëmarrjen e votuesve, duke minuar ligjshmërinë e institucioneve të zgjedhura. (5) Sipas Këshillit të Europës, dixhitalizimi i proceseve elektorale mund të jetë një alternativë e mirë për sigurimin e demokracisë edhe në kohë krizash akute si pandemia aktuale. KiE vazhdon të mbetet e vetmja organizatë ndërqeveritare që ka vendosur një sërë standardesh në fushën e e-voting për të garantuar të drejtën e votës nëpërmjet kanaleve të ndryshme në mënyrë që të rritet pjesëmarrja në zgjedhje, si dhe për të reduktuar kostot elektorale. Rekomandimi Rec(2004)11 (6) mbi standardet ligjore, operacionale e teknike të votimit elektronik, mbetet i vetmi burim për referencë rreth kësaj teme. Ky dokument është përdorur gjerësisht nga jurisprudenca kombëtare edhe në shtete jo-anëtare, si dhe nga aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Më pas, me rekomandimin e ri CM/Rec(2017)5 (7) u qartësuan aspektet themelore të e-voting dhe u caktuan edhe linja guidë mbi implementimin e

parashikimeve të Rekomandimit, i cili merret me pjesët më kritike të teknologjisë së zgjedhjeve në procesin nga hedhja e fletëve të votimit deri te numërimi i votave. Ka patur shumë zhvillime nga momenti kur u miratua nga Komiteti i Ministrave (Rec(2004)11): disa vende realizuan e-zgjedhje pilote dhe vendosën të mos e fusin si skemë në sistemet e tyre të brendshme, ndërsa të tjera vazhdojnë të përdorin skema pilote dhe të ndërpusin e-voting. Ka ndërkohë edhe vende të tjera (përfshirë Shqipërinë) ku ekziston vullneti për të lançuar skema pilote të e-voting por nuk kanë ekzaminuar ende të gjitha alternativat. Për këtë, Këshilli i Europës ka publikuar një udhëzues me hapat kyç për implementimin e këtyre skemave. Ndër standardet kryesore që duhen siguruar nëse implementohet sistemi e-voting sipas KiE, duhet patur parasysh se sistemi duhet të jetë i çertifikuar, i auditueshëm, si dhe i sigurt për agregimin dhe numërimin e të gjitha votave. Në çdo rast, Këshilli rekomandon që vendet të cilat dëshirojnë të ndërpusin në sistemet e tyre edhe e-voting, duhet ta bëjnë këtë në mënyrë graduale dhe progresive, duke u kujdesur të bëjnë paraprakisht të gjitha ndryshimet ligjore dhe të konstituojnë një trupë menaxhimi elektorale që do të jetë përgjegjëse për mirëfunksionimin e sistemit zgjedhor dixhital. Duke parë kriteret e listuara më sipër, kuptojmë se iniciativa për ndërfutje të menjëhershme të e-voting në Shqipëri në zgjedhjet e 25 prillit, do të ishte e parakohshme pavarësisht situatës që e dikton dhe objektivitet për të përfshirë aktivisht edhe elektoratin me vendbanim jashtë Shqipërisë, personat me aftësi të kufizuara dhe persona në gjendje të pamundësisë për tu paraqitur në qendrat e votimit. Edhe Komisioni i Venecias në Raportin mbi masat e marra nga vendet e BE-së si rrjedhojë e krizës Covid-19 dhe impaktin e tyre në demokraci, kujtoi se modalitetet e votimit ndikojnë drejtpërdrejt të pjesëmarrja. Të gjitha metodat e votimit në distancë (votimi me postë, votimi me internet apo telefon) e shtojnë pjesëmarrjen në votime, sidomos në rastin e pandemisë. Sidoqoftë të gjitha këto metoda përfshijnë rreziqe të ndryshme në terma të lirisë dhe fshehtësisë së votës duke patur parasysh edhe rreziqet e hakërimit apo sulmeve kibernetike në rastin e votimit me internet. Siç është përcaktuar në Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Elektorale, votimi me postë përshembull, duhet lejuar vetëm në ato vende ku shërbimi postar është i sigurt dhe i besueshëm, votimi në internet nga ana tjetër duhet të jetë teknologjikisht i sigurt, i besueshëm, i hapur për verifikim të pavarur dhe lehtësisht i aksesueshëm për zgjedhësit. Veç të tjerash, të gjitha format e-voting kanë vështirësi në mbikëqyrje, prandaj Komisioni i Venecias ka nënvizuar se, votimi elektronik është menduar për të plotësuar dhe jo për të zëvendësuar votimin tradicional.

Gerta Mehmeti, prill 2021

Zgjedhje në kohë pandemie – Çfarë kemi mësuar?

Situata e pandemisë globale Covid-19 solli kufizime të mëdha të lirisë civile e politike, duke shkaktuar shtyrjen apo përshtatjen e dhjetëra proceseve zgjedhore në botë, të cilët ishin planifikuar për tu mbajtur gjatë 2020-2021. Edhe në Shqipëri, më 25 prill 2021 u mbajtën zgjedhjet e radhës për Kuvendin e Shqipërisë, zgjedhjet e para të zhvilluara në kushte pandemie.



Ky artikull synon analizimin e problematikave që lidhen me këtë çështje dhe mësimet të nxjerra nga eksperiencia e Shqipërisë dhe shteteve të tjera. Së pari, ky artikull synon të analizojë ndikimin e pandemisë globale Covid-19 mbi procesin zgjedhor si të tillë, mbarëvajtjen e fushatave elektorale, ushtrimin e të drejtës së votës dhe të drejtave të tjera politike. Së dyti, ky artikull synon të ofrojë një qasje krahasimore të mbajtjes së zgjedhjeve gjatë periudhës së pandemisë në disa shtete në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit 2021 në Shqipëri, në raport me standardet ndërkombëtare dhe

praktikat më të mira. Së fundmi, ky artikull synon të nxjerrë disa konkluzione mbi masat që duhet të marrin shtetet, në mënyrë që të bëjnë të mundur mbarëvajtjen e proceseve demokratike dhe vijimin e garantimit të të drejtave politike edhe në kushtet e një pandemie globale.

Pandemia Covid-19 pati ndikim mbi procesin zgjedhor si të tillë, mbarëvajtjen e fushatës, si dhe ushtrimin e të drejtës së votës dhe të drejtave të tjera politike. Sfidat që u krijuan lidhen me mundësinë e të infektuarve apo të karantinuarve për të votuar, nevojën për të shmangur rritjen e rasteve të infektimit, përshtatjen e fushatës zgjedhore në kushtet e kufizimit të lëvizjes dhe tubimeve, transparencën dhe mundësinë për monitorim, si dhe nevojën për siguri dhe kushte të përshtatshme sanitare.

Koha e fushatës zgjedhore e gjeti Shqipërinë me një ndalim absolut mbi grumbullimet e më shumë se 10 personave, si dhe me liri lëvizje të kufizuar për shkak të orarit policor në fuqi. Pavarësisht kësaj, kufizimet shpesh herë u injoruan pasi vazhdimisht u mbajtën takime elektorale dhe mitingje në qytete të ndryshme. Masa ndëshkimore nuk u aplikuan ndaj partive politike, por vetëm ndaj kandidatëve të pavarur, duke evidentuar standarde të dyfishta. Nga ana tjetër, partitë politike dhe kandidatët e zhvendosën një pjesë të mirë të fushatës në mediat sociale dhe platformat e tjera në internet. Zhvendosja e fushatës në hapësirën dixhitale shoqërohet me sfida shtesë të cilat e gjetën Shqipërinë të papërgatitur. Këto sfida lidhen ndër të tjera me transparencën, disinformimin, manipulimin e opinionit publik dhe përpunimin/përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale. Një rast i mbledhjes dhe përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale të 910,000 votuesve në formën e një databaze rrodhi në media 10 ditë përpara zgjedhjeve. Databaza e rrjedhur përmbante të dhëna personale por edhe preferencat politike të supozuara të çdo zgjedhësi në Tiranë. Mendohet që këto të dhëna janë mbledhur dhe përpunuar nga partia në pushtet pa pëlqimin e personave, pra në shkelje të ligjit, si dhe duke përdorur informacion nga portali qeveritar e-albania. Implikimet dhe problematikat që mund të krijohen nga qarkullimi i këtyre të dhënave janë të panumërta dhe veprimtari të tilla cenojnë rëndë privatësinë, sigurinë e personave si dhe fshehtësinë e votës. Nga ana tjetër, me zhvendosjen e fushatës në territorin digjital, janë rritur shpenzimet për reklama online. Ndërkohë që Shqipërisë i mungojnë rregullimet e forta ligjore për kontrollin e financimit të fushatave zgjedhore, sipas BIRN, 123,152 dollarë amerikanë u shpenzuan për reklama politike dhe sociale nga partitë. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë se vetëm 113,252 dollarë janë shpenzuar nga partitë, kandidatët ose faqet që shpërndajnë reklama politike. Reklamat e tjera ishin nga media dhe nga kompani të cilat janë kategorizuar gabimisht nga algoritmi i Facebook-ut. Nga ana tjetër, zhvillimi i "luftës" politike online shpesh herë shoqërohet me manipulime të opinionit publik dhe disinformim. Vetë Facebook, ka dobësi në kontrollin e "sjelljeve jo autentike të koordinuara (CIB)" të cilat përdoren nga politikanët për të manipuluar opinionin publik nëpërmjet faqeve/profileve fallco, duke shfrytëzuar vakumin në rregullat e Facebookut. Sipas The Guardian, Shqipëria është një nga vendet e dyshuara për pasjen e një rrjeti në Facebook me profile fallco që kualifikohen si CIB. Sjellje të tilla online janë identifikuar edhe në një investigim të Exit.al në 2019 ku u zbulua që një rrjet profilesh fallco vepronin në mënyrë të koordinuar, duke komentuar në mënyrë pozitive postimet e politikanëve dhe duke sulmuar postimet kritike ndaj tyre. Kjo është konfirmuar edhe nga një ish-punonjëse e Facebook, bilbilfryrëse, sipas të cilës rasti i Shqipërisë ishte shumë serioz. Sjellje të tilla janë vënë re edhe gjatë periudhës së fushatës elektorale 2021 dhe kjo lloj mbështetje fallco në rrjetet sociale, mund të ndikojë në opinionin e publikut, duke e shtrembëruar atë dhe duke krijuar perceptimin që qeveria, apo politikanë të caktuar janë më popullore nga sa janë në të vërtetë. Zhvendosja e fushatës në një territor të parregulluar dhe të pamonitoruar plotësisht, siç është hapësira dixhitale, mungesa e transparencës, si dhe abuzimi me të dhënat personale të zgjedhësve për qëllime elektorale rrezikojnë të minojnë integritetin e zgjedhjeve *per se*.

Përveç zhvillimit të fushatës në kushte *sui generis* dhe në një territor të "pa rregulluar", situata e pandemisë shtroi problemin e votimit të personave të infektuar me Covid-19. Në këto raste, por jo vetëm, standardet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira sugjerojnë alternativa votimi për t'i bërë zgjedhjet të aksesueshme nga kushdo. Disa alternativa të tilla janë votimi me postë, votimi me prokurë, votimi në shtëpi apo në një institucion të posaçëm, votimi nëpërmjet teknologjisë etj. Këto alternativa votimi, në rastin e pacientëve me Covid-19, do tu mundësonin atyre në mënyrë të barabartë ushtrimin e të drejtës së votës, pa rrezikuar të tjerët apo veten. Shtete të ndryshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor të cilat zhvilluan zgjedhje gjatë pandemisë aplikuan disa prej këtyre metodave si psh. në Kroaci u zbatua votimi me prokurë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut, Kosovë dhe Mal të Zi u mundësua votimi në shtëpi ose institucione të caktuara. Në Shqipëri votimi i të infektuarve me Covid-19 nuk u lejua, duke u mohuar të drejtën e votës dhjetëra mijëra qytetarëve, duke i diskriminuar kështu për shkak të gjendjes shëndetësore. Kushtetuta e Shqipërisë lejon kufizime të të drejtës së votës vetëm për shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht, ose kur ligji përcakton kufizime për ata që vuajnë një dënim. Ndërkohë që Shqipërisë i është rekomanduar edhe më herët nga OSCE që të heqë kufizimin diskriminues të të drejtës së votës për personat e shpallur të paaftë mendërisht me vendim gjyqësor, ky kufizim jo vetëm që nuk është hequr, por u aplikua edhe mbi pacientët e infektuar me Covid-19. Në bazë të standardeve ndërkombëtare, kufizimet mbi të drejtën e votës janë të lejueshme vetëm nëse janë të arsyeshme, të përcaktuara në ligj dhe ngushtësisht proporcionale me objektivat dhe qëllimet që synojnë të arrijnë. Edhe sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të drejtave të njeriut, kufizimet *blanket* mbi një kategori të caktuar personash, janë gjetur në shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ (e drejta për zgjedhje të lira).

Një tjetër grup i përjashtuar nga votimi në zgjedhjet e 25 prillit 2021 ishte diaspora. Pavarësisht se ndryshimet e Kodit Zgjedhor të miratuara me shumë nxitim në 2020 mundësuan për herë të parë votën e diasporës, kjo risi nuk u vu në zbatim në zgjedhjet e 2021. Ky grup përbën rreth 35% të popullsisë votuese dhe në pamundësi të votimit nga larg, ishin të dekurajuar apo të pamundur për të udhëtuar për në Shqipëri për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19. Duhet theksuar që këto kufizime u shtuan 5 ditë para zgjedhjeve, me vendosjen e karantinës së detyrueshme 2 javore për udhëtarët nga Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Në vend që të adresohesh pjesëmarrja e ulët në zgjedhje dhe apatia e qytetarëve e cila ka mbizotëruar ndër vite, në zgjedhjet e 2021 u bë një përjashtim *a priori* mbi dy grupe votuesish, të infektuarit me Covid-19 dhe diaspora, fakt që mund të shihet si taktikë zgjedhore që çon drejt një devijimi të standardit të përfaqësimit.

Si përfundim, pandemia solli në vëmendje aspekte tradicionale të procesit zgjedhor që duhen rishikuar e përmirësuar, si dhe nevojën për të konsideruar mënyra alternative votimi, për të rritur aksesin, përfshirjen, si dhe për të shmangur diskriminimin e grupeve të caktuara. Kjo duhet shoqëruar me rritjen e kapaciteteve logjistike, alokimin e burimeve financiare të nevojshme si dhe me adresimin e implikimeve të lidhura me privatësinë dhe sigurinë. Së fundmi, pandemia nënvizoi rëndësinë e përmirësimit të komunikimit dhe mënyrave alternative të tij, si dhe ekspozoi dobësitë në kuadrin rregullator dhe ligjor sa i përket transparencës së burimeve të financimit të fushatave, mbrojtjes së të dhënave personale dhe luftimit të ndikimit të praktikave të pandershme në internet në integritetin e zgjedhjeve.

Megi Reçi, maj 2021

SOCIALE: Realiteti Dixhital

Gjykatat elektronike si mjet për të përshpejtuar bashkëpunimin gjyqësor midis Shqipërisë dhe Bashkimit European



Pandemia e Covid-19 nuk ishte ajo që prisnim, por ndoshta ishte ajo që duhej, veçanërisht kur bëhet fjalë për të nxitur përdorimin e teknologjive të informacionit në shumë fusha të ofrimit të shërbimeve qeveritare, duke përfshirë edhe sistemin gjyqësor. Prej vitesh në rang global ka nisur një fushatë reformimi dhe përshtatje drejt përdorimit të teknologjive të informacionit me qëllim lehtësimin e procedurave gjyqësore. Tashmë është bërë e qartë që dixhitalizimi i proceseve gjyqësore, një proces i përshpejtuar për shkak të pandemisë, është një proces i pakthyeshëm dhe se epidemia shërbeu vetëm për ta përshpejtuar.

Bashkëpunimi gjyqësor në kuadër të Bashkimit European synon të krijojë një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet shteteve anëtare, por jo vetëm, me qëllim shmangien e çdo pengese ndërmjet sistemeve juridike kombëtare. Me qëllim rritjen e bashkëpunimit gjyqësor për shtetet anëtare, BE ka krijuar portalin e-justice si një pikë unike aksesit në regjistrat kombëtar në fushën e drejtësisë. Shqipëria ka pasur një rritje të kërkesave për bashkëpunim në fushën gjyqësore në nivel europian, megjithëse ka ende punë për të bërë për të harmonizuar legjislacionin kombëtar me *acquis* e BE. Nëse përpunimi i këtyre kërkesave do të kryhej duke u bërë pjesë e portalit e-justice, do të kishte një ulje të kohës së shqyrtimit të tyre, por kjo nuk mund të realizohet pa një reformim të punës së përditshme të gjykatave në vend.

Diversiteti i juridiksioneve të vendeve anëtare të Bashkimit European, ka evidentuar nevojën për gjetjen e një emëruesi të përbashkët, me qëllim lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet këtyre sistemeve juridike. Në një treg të përbashkët siç është ai i Bashkimit European, ku njerëzit, mallrat, shërbimet dhe kapitalet lëvizin lirisht, 27 sisteme juridike të ndryshme përbëjnë pengesë reale në shumë prej aspekteve të lidhura drejtpërdrejtë me lëvizjen e lirë. Ka qenë pikërisht kjo premisë, që ka sjell zhvillimin e politikave në fushën e bashkëpunimit gjyqësor.

Bashkëpunimi gjyqësor si një mundësi për të eliminuar pengesat ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit European, që lindin si rezultat i mospërputhjeve ndërmjet sistemeve të ndryshme ligjore, nuk ka qenë pjesë e

traktateve themeluese. Për herë të parë do të jetë Traktati i Mاستrihtit, i cili do ta përfshinte në kuadër të "çështjeve me interes të përbashkët" (Neni 51, Titulli VI, Traktati i Mاستrihtit, 1992). Traktati i Amsterdamit do e vendoste bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile dhe penale në nivel komunitar, duke e lidhur atë me lëvizjen e lirë të personave (Titulli VI, Traktati i Amsterdamit, 1997).

Traktati i Lisbonës jep mundësi të reja për bashkëpunimin gjyqësor në çështje civile dhe penale dhe ngarkon Bashkimin European, me detyrën e lehtësimit të aksesit në drejtësi në mbarë BE-në, duke bërë një rregullim të plotë të këtij aspekti të rëndësishëm të integritit, në nenet 81 dhe 82 të tij (Përmbledhje e Traktateve të BE dhe TFBE). Në vija të përgjithshme bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale dhe civile konsiston kryesisht në: njohjen e ndërsjellë të aktgjyqimeve si dhe vendimeve në çështjet jashtëgjyqësore ndërmjet juridiksioneve të ndryshme; marrjen e provave; njoftimin e palëve pjesëmarrëse në proces; përafrimin e procedurave dhe përputhshmërinë e rregullave; respektimin e të drejtave të individit në procedurën penale, etj..

Republika e Shqipërisë në kuadër të proceseve integruese në Bashkimin European dhe veçanërisht në zbatim të kapitujve të MSA-së, ka filluar prej kohësh të hedhë hapa konkretë në këtë drejtim. Për sa i përket bashkëpunimit gjyqësor, njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të huaja është përfshirë në të dy Kodet që rregullojnë Procedurat Civile dhe ato Penale në vend. Në Republikën e Shqipërisë institucioni përgjegjës për realizimin e politikave konkrete në fushën e bashkëpunimit gjyqësor është Ministria e Drejtësisë, e cila ndër të tjera ka si mision: bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale (Ligji Nr.8678, neni 5, 2001).

Prej disa vitesh Shqipëria është pjesë e programeve të drejtësisë së BE-së, nëpërmjet miratimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e drejtësisë së BE-së. I fundit është ai i ratifikuar me ligjin nr. Nr. 82/2018. Ky memorandum ka të bëjë konkretisht me anëtarësimin e Shqipërisë në Programin e Drejtësisë së BE-së, i krijuar me Rregulloren 1382/2013 të Parlamentit European dhe Këshillit. Kjo rregullore, e cila rezulton të jetë ende në fuqi parashikon mundësinë që pjesë e programit të bashkëpunimit me Bashkimin European të bëhen edhe shtetet e treta (neni 7/1,c; EUR-Lex).

Teknologjia e informacionit është padyshim një ndër faktorët thelbësor në ndryshimin e botës në të cilën jetojmë. Në një kohë kur kjo teknologji po bëhet pjesë e pandashme dhe e domosdoshme e të gjitha sferave të veprimtarisë njerëzore, nga tregtia, tek komunikimi, apo edhe mjekësia, nuk mund të rrinte jashtë këtij ndikimi gjyqësori, dhe zhvillimi i procedurave gjyqësore në tërësi. Shtetet janë vazhdimisht në kërkim të mënyrave të reja për të rritur eficiencën e gjykatave dhe për të shmangur vonesat e tejzgjatura të proceseve. Vonesa e proceseve gjyqësore në fakt është një ndër ankesat më të shpeshta që shoqëron këtë fushë të veprimtarisë publike (Reiling, 2009; CEPEJ, 2005). Në një botë të re, ku asnjë shtet nuk mund t'i shmanget zhvillimeve të vrullshme globale në fushën e teknologjisë së informacionit, është e natyrshme që shtetet ta shohin këtë të fundit, si një mundësi për të gjetur një zgjidhje për vonesat në gjyqësor. (Reiling, 2009) Studimet tregojnë se përdorimi i teknologjisë së informacionit për zhvillimin e procedurave gjyqësore rrit transparencën dhe efektivitetin e sistemit gjyqësor (Thornburg, 2001; CEPEJ, 2016; Council Action Plan on European e-Justice 2009-2013).

Teknologjitë e komunikimit të informacionit mund të përdoren për të përmirësuar administrimin e sistemit të drejtësisë (Cerrilo, Fabra, 2008). Teknologjia e informacionit jep mundësinë për automatizimin e një sërë procedurash gjyqësore, duke ulur kohën e kryerjes së procedurës, koston e saj dhe si rezultat sjellin rritje të efektivitetit. Interneti nga ana tjetër, ofron mundësinë për të siguruar një akses të shpejtë dhe efikas të publikut në gjyqësor, duke i dhënë mundësinë për të pasur informacion të përgjithshëm, apo specifik në kohë të shkurtër dhe pa pasur nevojë për të qenë fizikisht në ambientet e gjykatës. Në analizë të fundit kjo nuk bën gjë tjetër veçse rrit legjitimitetin e gjyqësorit (Velicogna, 2007).

Vendet anëtare të Bashkimit European, edhe pse me hapa të ndryshëm, kanë ecur në drejtim të përfshirjes së teknologjisë në fushën e dhënies së drejtësisë, në të gjithë aspektet e saj. Nevoja për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor ndërkufitar, solli ndryshimin edhe të procedurave që kryheshin në kuadër të BE. Pikërisht për të arritur objektiva konkretë në këtë drejtim, në nëntor të vitit 2008, u krijua portali e-justice, i menaxhuar nga Komisioni European, me objektivin për të përmirësuar aksesin në drejtësi dhe ofrimin e

drejtësisë, duke krijuar një "one-stop-shop"- shërbim me një ndalesë (IUJO), për aksesin në drejtësi në të gjithë BE-në.

Portali lehtëson punën e përditshme të praktikuesve të së drejtës dhe autoriteteve ligjzbatuese. Referuar strukturës së ofrimit të shërbimeve nga portali, ai adreson këto kategori specifike përfutuesish të shërbimeve të tij: qytetarët; shoqëritë tregtare; praktikuesit e të drejtës; gjyqësorin. Secila prej këtyre kategorive, në përputhje me interesat dhe nevojat e veta ka mundësinë të marrë informacion të detajuar për secilin prej sistemeve juridike të 27 shteteve anëtare të BE-së. Informacioni ofrohet në 22 gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian. Në shumicën e rasteve informacioni shoqërohet edhe me linkun përkatës, në faqen zyrtare të institucionit kombëtar përkatës. Veçoria kryesore e këtij portali është unifikimi, pra i gjithë informacioni i vënë në dispozicion, është i aksesueshëm drejtpërdrejtë në këtë portal. Në portal është e mundur të aksesohet një numër i konsiderueshëm aktesh juridike të vendeve anëtare; mund të merret informacion i përgjithshëm lidhur me procedurat gjyqësore; paraqitjen e kërkesë padisë, apo të kallëzimit; kontaktet me avokatë, apo profesionistë të tjerë të së drejtës; marrjen e provave me videokonferencë apo forma të tjera; ekzekutimi i vendimeve penale apo civile; ndjekja e procedurave të falimentit, etj.. Plani Europian i Veprimit e-Justice 2019-2023 (2019/C 96/05), që bën reformimin e fundit të portalit, parashikon një sërë reformash në fushën e komunikimit elektronik dhe dixhital ndërmjet vendeve anëtare të BE-së, (2019-2023 Action Plan European e-Justice) me synimin për ta thelluar bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të përfshirë. Referuar këtij dokumenti, ky plan do të punojë që të arrijë: Përmirësimin e aksesit në informacion në fushën e drejtësisë; Përmirësimin e dixhitalizimit të procedurave gjyqësore dhe jashtëgjyqësore; Arritjen e zbatimit dhe manaxhimit teknik të sistemeve kombëtare të e-justice me synim për të lehtësuar ndërveprimin dhe ndërlidhjen ndërmjet sistemeve të shteteve anëtare.

Përmbledhja e plotë e gjithë seksioneve që janë të përfshira në këtë portal, është e pamundur të kryhet për efekt të këtij artikulli. Ajo që mund të thuhet është që ky portal synon të jetë gjithëpërfshirës, për të gjitha kategoritë e marrëdhënieve juridike apo gjyqësore me element ndërkufitar.

Bashkëpunimi gjyqësor në fushën civile dhe penale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, është i konsoliduar. Nëse shohim shifrat e tre viteve të fundit është e qartë se ato janë në vlera të rëndësishme si nga pikëpamja sasiore dhe cilësore. Gjatë tre viteve të fundit Shqipëria për çështjet civile ka marrë mesatarisht 280 kërkesa për bashkëpunim nga vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe ka dërguar mesatarisht 140 të tilla. Ndërkohë për çështjet penale, numri i kërkesave për bashkëpunim të përcjella është mesatarisht 1230 kërkesa, dhe i atyre të marra është 1130. Analiza e Progres Raporteve të Komisionit Europian, për tre vitet e fundit, krahas konstatimit të hedhjes së hapave pozitivë në drejtim të forcimit të bashkëpunimit, arrin në përfundimin se Shqipëria duhet të përmirësojë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar, zbatimin në kohë të instrumenteve shumëpalëshe dhe kapacitetet institucionale. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me acquis të BE dhe për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor (KE, 2018, 2019, 2020).

Shqipëria prej vitesh ka në fokus të saj rritjen e përdorimit të teknologjive të informacionit në gjyqësor (Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2015-2020). Megjithatë nëse analizohen ndryshimet në praktikë, është e qartë se hapat e hedhur nuk janë të konsiderueshëm krahasuar me objektivat dhe nevojën për progres. Të gjitha gjykatat në vend janë përfshirë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, por ky sistem vazhdon të jetë problematik, për arsye se nuk është unik për të gjitha fazat e procedurave gjyqësore dhe për të gjitha gjykatat në vend. Menaxhimi elektronik i çështjeve fillon në momentin e shortimit elektronik, pas paraqitjes së kërkesës apo kërkesë padisë nga ana e palëve. Padia iu caktohet gjyqtarëve me short (Kodi i Procedurës Civile, Neni 154/a). Më tej kryhet planifikimi elektronik i seancave gjyqësore, regjistrimi i zhvillimit të seancave gjyqësore, deri në mbylljen dhe depozitimin elektronik të çështjeve të përfunduara. Në gjykatat shqiptare është instaluar sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore, i cili përdoret në pjesën më të madhe të seancave (Raporti KLGJ, 2019). Fazat e mësipërme nuk administrohen nga i njëjti sistem elektronik, duke vështirësuar komunikimin me publikun dhe duke e bërë të pamundur komunikimin elektronik ndërmjet vetë gjykatave. Centralizimi i databazës së të dhënave të sistemit gjyqësor, do të sillte mundësinë për të pasur regjistra online të të dhënave të ndryshme gjyqësore, të cilat edhe pse janë të lokalizuara, të pavarura dhe të mëvetësishme në secilën gjykatë, do të menaxhoheshin nga i njëjti sistem. Në këtë mënyrë, subjektet e përfshira në një proces gjyqësor, e veçanërisht profesionistët do të komunikonin në mënyrë eficiente e reale mes tyre. Pa u


arritur që sistemi të mundësojë publikim të informacionit për proceset gjyqësore në kohë reale dhe të përditësuar për publikun shqiptar, do të jetë e pamundur që sistemi të integrohet në portalin e-justice të Bashkimit Europian.

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile është një proces në zhvillim në Bashkimin Europian. Për të rritur efektivitetin e këtij bashkëpunimi që është thelbësor në rritjen e ndërveprimit midis Shqipërisë dhe BE-së, është e nevojshme që të ketë koordinim midis politikave kombëtare në këtë fushë, me politikën e Bashkimit Europian, të cilat në fakt dëshmojnë për një zgjerim të vazhdueshëm të tij. Zgjerimi i këtij bashkëpunimi në vendet anëtare të BE-së, po ecën paralelisht me dixhitalizimin e procedurave gjyqësore, duke qenë se këto procese në fakt e lehtësojnë njëri-tjetrin, pasi rritja e përdorimit të teknologjisë së informacionit, vetëm rrit më shumë mundësitë për bashkëpunim ndërmjet sistemeve të ndryshme juridike.

Në kushtet aktuale, edhe pse nuk paraqitet asnjë pengesë në kuadër të legjislativës që rregullon marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, mund të themi se përfshirja e sistemit të drejtësisë shqiptare, në portalin e BE-së është ende e largët. Përpara se Shqipëria të ketë mundësi të pretendojë për të qenë pjesë e këtij portali, duhet që më së pari të garantojë brenda vendit një unifikim të sistemeve elektronike në gjyqësor dhe një zhvillim të tyre, duke mundësuar transferimin e një numri të konsiderueshëm procedurash në format elektronik. Në kushtet kur pandemia e Covid-19, dëshmoi se sa e nevojshme është për sistemin gjyqësor që të jetë në gjendje të funksionojë edhe jashtë godinave të gjykatave, për Shqipërinë, ambicia për t'u bërë pjesë e sistemit të drejtësisë elektronike të BE, është një shtysë më shumë, për të ndërmarrë reforma të rëndësishme në drejtëm të drejtësisë elektronike. Në kuadër të shkëmbimit të praktikave të mira lidhur me bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile dhe penale, eksperiencën e Bashkimit Europian mund të shërbejë si një udhërrëfyes për ndërmarrjen e reformave efikase në këtë fushë.

Dorina Ndreka Asllanaj, mars 2021

Një realitet i ri dixhital - përshpejtimi i dixhitalizimit dhe qasja gjithëpërfshirëse



Më 15 janar 2021, Wikipedia mbushi 20 vjeç. E krijuar në 2001, një enciklopedi dixhitale e ushqyer nga vullnetarë, numëron 55 milion artikuj në më shumë se 200 gjuhë, duke rezultuar si website më i madh i referuar, ku sipas The economist kompani si Apple dhe Amazon mbështeten në të, për të mundësuar përgjigjen e pyetjeve nga asistentët dixhital Alexa dhe Siri. Deri më sot, një algoritëm dixhital, si Wikipedia, e shumë sisteme të tjera teknologjike, nuk janë konsideruar veçse metoda që ofrojnë lehtësim në shërbime, praktikizëm në komunikim e madje në jo pak raste, mjete

përfitim të marramendëse.

Në libra e artikuj të shumtë, shpesh herë jemi hasur në analiza e opinione që lidhen me të ardhmen e njerëzimit, duke ju referuar dixhitalizimit të jetesës, zhvillimeve të teknologjisë dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës, deri në zëvendësimin e profesioneve të vjera njerëzore, me inteligjencën artificiale. Pra, si domosdoshmëri, dixhitalizimi i çdo aspekti të jetës pritej në "epokën futuriste", atëherë kur ndoshta dhe makinat do të fluturojnë e nuk do drejtohen më nga njerëz, përveçse nga robotë.

E në fakt, jo më larg sesa nga viti i trishtë 2020 që lamë pas, e në vazhdim viti që po jetojmë si simotër e tij, po manifestohet gjithnjë e më shumë nevoja e dixhitalizimit të shoqërive mbarë globale, "për të jetuar shëndetshëm". Tanimë, me krizën e pandemisë që po përjeton bota, jemi para faktit që dixhitalizimi, përveçse është bërë mënyrë jetese, është shndërruar në domosdoshmëri. Forma më e shpeshtë e komunikimit është dixhitale; ofrimi i shërbimeve është drejt perfeksionit dixhital; është dixhitale puna ideale; është dixhitale mësimdhënia; është dixhitale edhe ekonomia etj.

Që prej fillimit të vitit 2020, lëvizja fizike e mallrave dhe njerëzve është e kufizuar, ndërsa tregtia dixhitale po luan një rol vendimtar në mbajtjen e rrjedhës së tregtisë. Nga e-tregtia ndërkufitare dhe pagesa dixhitale, deri tek telekonferencat me partnerë biznesi në të gjithë botën tek zëvendësimi i dokumenteve fizike me regjistrime

elektronike, aktivizimi i transaksioneve dixhitale në mallra dhe shërbime, është më i rëndësishëm se kurrë. Nëse do të marrim rastin e kompanisë Alibaba, e cila para 7 vitesh u prek nga virusi SARS në Kinë dhe që asokohe ishte një start-up 4 vjeçar, nuk dihej nëse kompania do t'i mbijetonte krizës. Kompania e shfrytëzoi karantinën duke vazhduar punën nga shtëpia, periudhë në të cilën lançoi Taobao, platformën e parë të kompanisë në shërbim të konsumatorëve dhe tregun online me pakicë më të madh në botë sot. Siç është reflektuar në rastin e Alibaba-s në Kinë, por jo vetëm, një sistem i ndërtuar mbi ekonominë dixhitale është elastik, i zhdërvjellët dhe i aftë të përshtatet me ndryshimet. Aktualisht qasja ideale është të krijohen një sërë rregullash globale në çështjet e ekonomisë dhe tregtisë, në kuadrin e globalizimit dixhital.

Pandemia ka detyruar gjithashtu edhe pushtetin e drejtësisë në mbarë globin të dixhitalizohet me nxitim. Paketa stimuluese Covid-19 e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfshin një dispozitë ku parashikohet që gjyqtarët federale të përdorin telekonferencën për zhvillimin e seancave gjyqësore. Gjykata Supreme në Amerikë, zhvilloi seanca dëgjimore për herë të parë përmes telefonit. Gjykata Supreme e Indisë filloi të dëgjojë të gjitha çështjet në një aplikacion të quajtur Vidyo në 23 mars të 2020. Gjithashtu, Spanja zhvilloi gjyqin e parë në internet në maj të vitit 2020. Teknologjia mund ta bëjë drejtësinë më të lirë dhe më të arritshme. Seancat dëgjimore në dhomat e konferencave digjitale mund të jenë më të lehta sesa ato fizike, për t'u ndjekur edhe nga reporterët që mbulojnë gjykatat. Gjetjet fillestare sugjerojnë një divergjencë midis degëve të sistemit të drejtësisë.

Çështjet civile - ato pa juri në sistemin common law - duket se transferohen lehtësisht në hapësirën e internetit. Më 5 qershor 2020, Këshilli i Drejtësisë Civile në Britani, publikoi një raport që anketoj më shumë se 1000 avokatë, gazetarë dhe anëtarë të publikut që kishin marrë pjesë në çështje civile të zhvilluara online që nga mesi i marsit. Rreth 71.5% e të anketuarve thanë se kishin përvojë pozitive ose shumë pozitive me dëgjime në distancë. Për sistemet ligjore, pandemia ka arritur në një eksperiment të papritur, për disa muaj, nëpërmjet procedurës dixhitale.

Edhe në vendin tonë pandemia u ndje jo pak në sistemin gjyqësor. Për fat të keq, gjykatat u mbyllën përkohësisht, pa një zgjidhje të shëndetshme alternative. Megjithatë Shqipëria mund të fillojë të ecë drejt dixhitalizimit gjyqësor përmes krijimit të një task force/grupi pune, i cili mund të fokusohet posaçërisht, që mund të mbledhë rezultate nga vendet e tjera, të identifikojë dhe të bazohet në rreziqe, si dhe të përpiqet t'i adresojë ato. Grupi i punës mund të krijojë një qasje në faza dhe të identifikojë mundësitë për dixhitalizim, kur ka më pak rrezik dhe të pilotojë nisma të tilla përpara se të identifikojë rrugë të tjera për dixhitalizimin pilot të të gjithë hallkave të sistemit të drejtësisë.

Megjithatë një teknologji e tillë është e paprovuar në shkallë. Kërkimet e deritanishme mbi ndikimin e tij kanë qenë jo përfundimtare. Në Britani gjyqtarët kanë folur për vështirësinë e trajtimit të çështjeve delikate siç është p.sh. kujdestaria e fëmijëve. Gjykatësit e çështjeve të tilla, shpesh flasin drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në fund të gjykimeve për të shpjeguar vendimet e tyre. Interneti zvogëlon mundësitë për të ofruar ndjeshmëri jashtë formaliteteve të rregullta të dëgjimit.

Në fakt, ndër mbrojtësit e të drejtave të njeriut, ka nga ata që argumentojnë se dhënia e dënimeve të ashpra nga distanca është "çnjerëzore" - nëse do të vendoset që dikush të dënohet me vdekje – si në rastet e sistemeve common law – kjo nuk mund të bëhet nëpërmjet Zoom-it.

Për shkak të pandemisë Covid-19, edhe objektet arsimore në të gjithë globin janë detyruar të mbyllën përkohësisht për sigurinë e stafit dhe studentëve të tyre, duke detyruar gjenerimin e një sistemi të ri online, të mësimdhënies. Kompani të shumta po priren gjithnjë e më shumë drejt zhvillimit të teknologjive të reja të mësimdhënies, nëpërmjet dixhitalizimit. Në një rast interesant nga Kenia, një iniciative interesante e-Learning e kompanisë Huawei Technologies, ka bërë të mundur që mbi 15 milion studentë të mund të mësojnë nga shtëpia, nëpërmjet programit Learn On, i cili siguron burime me cilësi të lartë në një platformë të hapur, së bashku me mbështetje financiare për të siguruar vazhdimësinë arsimore. Dhjetë universitete në Kenia dhe qindra studentë kanë shfrytëzuar burimet në dispozicion përmes programit Learn On dhe më shumë se 500 studentë janë pajisur me pako të të dhënave për të mundësuar studimin në internet.

Ndërsa në Kroaci, klasat 1-4 të shkollës fillore, gjatë muajit maj të 2020, filluan të organizohen përmes TV publik: mësuesit u dërgonin prindërve ushtrime shtesë për studentët. Duke pasur parasysh moshën e tyre, nuk pritej që këta fëmijë ta përdorin vetë internetin direkt, por përkundrazi ata komunikonin me mësuesit e tyre përmes prindërve të tyre. Mësimet në video viheshin në dispozicion si përmes TV ashtu edhe përmes internetit. Për më tepër, secila shkollë kishte të organizuar një dhomë virtuale të mësuesve dhe klasë virtuale në platforma të ndryshme (Loomen, Microsoft Teams, Yammer) ku mësuesit komunikonin çdo ditë me nxënësit e tyre, duke dhënë udhëzime, duke kontrolluar veprimtarinë e tyre dhe përfundimin e detyrave. Kompanitë e telekomunikacionit gjithashtu ofronin qasje në internet falas (përmes kartave SIM) për nxënësit me status më të ulët socio-ekonomik. Një qasje thuajse e njëjtë, u ndoq edhe në vendin tonë. Edhe pse aktualisht, mësimdhënia, për grup-mosha të caktuara po zhvillohet në klasa fizike, duke respektuar rregullat bazë të shmangies së përhapjes së virusit, ndërsa për të tjerë (sikundër janë studentët) procesi i mësimdhënies zhvillohet online. Gjatë 2020 nisi një cikël i ri mësimdhënieje nëpërmjet televizionit, duke dedikuar një kanal dixhital, për shpjegimin e klasave të caktuara.

Në të gjithë këto përshpejtime të zhvillimeve të një realiteti të ri dixhital, në fakt duhet konsideruar që jo të gjitha vendet mund të jenë të gatshme mjaftueshëm, për t'u përshtatur menjëherë ndaj këtij ndryshimi të menjëhershëm. Vendi ynë, mund të jetë një rast, ku edhe pse aktualisht, ka pasur një përpjekje serioze për dixhitalizimin e ofrimit të disa shërbimeve (një rast i suksesshëm është platforma e-Albania, ku qytetarët mund të aksesojnë disa shërbime, që më herët ofroheshin nëpërmjet burokracive), shtrirja gjithëpërfshirëse e dixhitalizimit të jetës mbetet ende mes pengesave. Këto pengesa mund të jenë të shumta, nisur që nga kultura dhe edukimi i brezave të caktuar të shoqërisë, që mund të kenë vështirësi të kuptueshme të aksesimit apo përdorimit të mjeteve teknologjike, e deri tek mundësitë ekonomike për të poseduar një paisje dixhitale.

Një tjetër faktor i rëndësishëm, që duhet konsideruar në të gjithë këtë epokë të re, është sigurisht edhe krimi kibernetik, i cili ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e shëndetshëm të jetesës dixhitale. Një raport i ri i Forumit Ekonomik Botëror, mbi Parimet e Udhëheqjes së Sigurisë Kibernetike: Mësimet e marra gjatë pandemisë Covid-19 për tu përgatitur për "normalitetin e ri", synon të udhëheqë sigurinë në internet dhe veçanërisht tek drejtuesit e bizneseve, pasi ata janë përgjegjës për një pjesë të veprimeve që balancojnë qëllimet afatshkurtra kundër imperativëve të mesme dhe afatgjata. Propozimet janë që duhet të nxitet një kulturë e rezistencës kibernetike dhe kjo kulturë të jetë gjithëpërfshirëse dhe të depërtojë veçanërisht në bizneset, të cilat mund të goditen dhe të pësojnë humbje nga këto krime. Menaxhimi efektiv i rrezikut kibernetik mund të ndihmojë bizneset të arrijnë një transformim më të zgjuar dhe më të shpejtë dhe të qëndrojnë në këmbë në këto kohë të pasigurta.

Duhet ritheksuar se shpejtësia me të cilën po ndodh ky dixhitalizim, e nxitur nga situata e krizës aktuale, bën që efektet, në fakt, të jenë të vështira për t'u parashikuar, por është e sigurt që do të ndikojnë në riformatimin e shumë sektorëve, edhe pasi të ketë mbaruar pandemia e Covid-19. Ndërsa kriza vazhdon, zhvendosja e pashmangshme drejt shërbimeve dixhitale do të përshpejtohet, duke penetruar gjithnjë e më shumë në çdo sektor të jetës tonë.

Lorina Misku, prill 2021



Fjalor:

Bashkimi doganor

Bashkimi doganor është elementi thelbësor i tregut të përbashkët. Masat më të rëndësishme për krijimin e Bashkimit Doganor përfshinin:

- Eliminimin e të gjitha detyrimeve doganore dhe kufizimeve sasiore midis Shteteve Anëtare;
- Krijimin e një Tarife të Përbashkët Doganore (CCT), e cila zbatohet në të gjithë Komunitetin Europian për mallrat nga vendet e treta (të ardhurat e fituara nga këto tarifa doganore përbëjnë një pjesë të të ardhurave të vetë Komunitetit).
- Politikën Tregtare të Përbashkët si një shtrirje të jashtme të Bashkimit Doganor (Komuniteti flet me një zë në nivel ndërkombëtar).

Deficiti demokratik

Është një koncept i cili bazohet kryesisht mbi argumentin se Bashkimi Europian dhe institucionet e tij vuajnë nga mungesa e demokracisë dhe duken të paarrtshme nga qytetar i thjeshtë, pasi metoda e funksionimit të tyre është shumë e ndërlikuar. Në çdo hap të ri të procesit të integritit europian, çështja e legjitimitetit demokratik është bërë gjithnjë e më e ndjeshme. Traktatet e Mاستrihtit, Amsterdimit dhe Nisës hodhën hapat e parë drejt përfshirjes së parimit të legjitimitetit demokratik në sistemin institucional, duke zgjeruar kompetencat e Parlamentit në lidhje me emërimin dhe kontrollin e Komisionit dhe duke e zgjeruar gradualisht fushën e përdorimit të procedurës së vendimmarrjes së përbashkët. Një nga qëllimet e qarta të Traktatit të Lisbonës, shprehur që në parathënien e tij, është rritja e legjitimitetit demokratik të Bashkimit.

Europë "a la carte"

Nënkupton një model integrimi me nivele të ndryshme, në të cilin shtetet e veçanta anëtare zgjedhin si një nga menu "a la carte" politikën në të cilat ata duan të marrin pjesë dhe të përfshihen plotësisht, duke ruajtur megjithatë një numër minimal objektivash të përbashkëta.

Kriteret e Kopenhagenit

Të ashtuquajturat "Kriteret e Kopenhagenit", përcaktuar nga Këshilli Europian mbajtur në dhjetor të 1993 në Kopenhagen, kërkojnë që vendi kandidat të ketë: - Kriteri Politik: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve; - Kriteri Ekonomik: një ekonomi tregu funksionale, si dhe aftësinë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut që veprojnë brenda Bashkimit Europian; - Kriteri i Acquis: aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në mënyrë të veçantë objektivat politike, ekonomik dhe të bashkimit monetar. Këshilli Europian i Madridit, mbajtur në dhjetor të 1995, shtoi një kriter të katërt në grupin e kriterëve të Kopenhagenit. Sipas këtij kriter kërkohet që vendi kandidat të aplikoj rregullat dhe procedurat e BE-së përmes përshtatjes së strukturave të tij administrative. Rëndësia e krijimit të strukturave të duhura administrative dhe gjyqësore është një parakusht për zbatimin efektiv të legjislacionit të BE-së.

MBI EUROSPEAK:

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) ka lançuar EuroSpeak në fillim të vitit 2011, si revista e parë në Shqipëri që fokusohet në çështjet e BE-së. Nga vetë emri, EuroSpeak (gjuha e përdorur nga burokratët në Bruksel dhe shpeshherë e kuptueshme vetëm për ekspertët), revista është projektuar për të përcjellë tek publiku i gjerë në një gjuhë më të lexueshme dhe jo teknike thelbin e debateve në gjirin e institucioneve të BE-së. Ajo synon të zvogëlojë hendekun aktual informativ mbi tema të tilla duke aspiruar të propozojë analizë cilësore dhe të pavarur e cila shkon përtej listimit të thatë të fakteve apo deklaratave të politizuara mbi integrimin në BE që ndeshen shpesh në media. Njëzët e një botime të printuara janë publikuar në gjuhën shqipe mbi analizat e debateve dhe zhvillimeve kryesore në Bruksel, si dhe një seri raportesh dhe intervistash me personalitete kyçe mbi përparimin e Shqipërisë drejt BE-së.

Në 2014 bazuar në zhvillimet e mediave online dhe interesit gjithnjë në rritje për EuroSpeak, avancuam një hap më tej duke sjellë një informacion dhe analizë të tillë nëpërmjet krijimit të një portali elektronik informacionesh në shqip të dedikuar posaçërisht temave të BE-së. Portali elektronik me artikuj i EuroSpeak është faqja e parë në shqip e krijuar mbi çështjet e BE-së duke mundësuar një hapësirë të re informacioni për publikun. Një përparim i tillë u krijon mundësi aksesit qytetarëve dhe profesionistëve të rinj përtej Tiranës, nëpërmjet përhapjes së internetit në mbarë vendin. Për më tepër lejon një analizë më të qartë dhe të freskët duke mbajtur publikun të informuar virtualisht në kohë reale mbi debatet dhe pikat kryesore në BE.

Nisma për të sjellë këtë organ të ri informimi frymëzohet nga përvoja e akumuluar deri më tani nga EMA për sa i përket analizimit dhe nxitjes së debatit mbi aspekte të ndryshme të integritit, duke synuar kësaj here që të informojë një audiencë më të gjerë e cila ushqen interes për zhvillimet në BE dhe procesin e zgjerimit të saj. Artikujt e EuroSpeak janë artikuj origjinalë të realizuar nga stafi i EuroSpeak dhe autorë, gazetarë e ekspertë të fushave të ndryshme.

Që nga janari i 2020 EuroSpeak po mbështetet financiarisht nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy

